



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 1631/ Prot.

Pogradec, më 30. 04. 2025

VENDIM

NR. 40, DATË 29. 04. 2025

PËR
"MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR RININË
NË BASHKINË POGRADEC 2025-2028".

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a"; të nenit 9, nenit 54, gërma "dh", të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, si dhe bazuar në Ligjin 75/2019 "Për Rininë", Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029, Këshilli Bashkiak Pogradec në mbledhjen e tij të datës 29. 04. 2025 shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë, pranë Bashkisë Pogradec, për miratim e Planit Lokal të Veprimit për Rininë në Bashkinë Pogradec 2025-2028"

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Rininë në Bashkinë Pogradec 2025-2028.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë.
3. Ky urdhër hyn në fuqi në datën / /2025.

KRYETARË E KËSHILLIT
Manjola KAMOLLI



1. Miratuar me 20 vota

2. Vota Pro 20

3. Vota Kundër 0

4. Vota Abstenim 0

5. Zbardhur më date 30.04.2025

PARATHËNIE

Ky Plan Veprimi, u hartua nga Bashkia Pogradec në bashkëpunim me Qendrën për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri, me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Ministrit të Shtetit për të Rinjtë dhe Fëmijët.

Në këtë proces, u përfshinë mbi 100 të rinj dhe të reja të interesuar që jetojnë në qytetin e Pogradecit, në qytet dhe në fshat, organizatat rinore të cilat operojnë në nivel lokal, ofruesit e shërbimeve dhe çdo grup tjetër interesi që shprehu dëshirën për të mbështetur këtë proces.

Plani i Veprimit 2025-2028, u hartua nëpërmjet një procesi të gjerë konsultimi. Në total u zhvilluan 2 workshope dhe takime konsultuese me të rinj e të reja dhe me përfaqësuesit e Bashkisë Pogradec, me qëllim vendosjen e prioriteteve strategjike dhe objektivave që ndikojnë në përmirësimin e jetës sociale, kulturore, ekonomike dhe përfshirjes të të rinjve në Pogradec.



"Rinia ka potencial dhe ne duhet të kemi kurajon të ndërrojmë mendësitë dhe praktikat e vjetra dhe ta orientojmë fuqinë e tyre drejt qëllimeve të mira." - Mary McLeod Bethune



FALENDERIME

Plani Lokal i Veprimit i Bashkisë Pogradec për të Rinjtë, u bë i mundur falë mbështetjes së Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Ministrisë të Shtetit për të Rinjtë dhe Fëmijët në kuadër të zbatimit të projektit "Shërbime të Integruara Rinore në Qarkun Korçë".

Bashkia e Pogradecit dëshiron të falenderojë përzemësisht Qendrën për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri - CRCA/ECPAT Shqipëri, që lehtësuan procesin e hartimit të këtij plani prej zhvillimit të takimeve konsultuese me të rinj e të reja, nxënës, gjimnazistë dhe grupet rinore, e që mundësuan dhe lehtësuan mbledhjen e informacionit nga organizatat që punojnë me dhe për të rinjtë në nivel lokal. Pa ndihmën e tyre, hartimi i Planit Lokal do kishte qenë i pamundur.

Në mënyrë të veçantë Bashkia e Pogradecit falenderon të gjitha shkollat 9-vjeçare dhe të mesme, grupimet rinore, organizatat rinore, aktivistët rinor, të cilët u përfshinë në mënyrë aktive në procesin e konsultimit gjatë workshopeve që u organizuan për hartimin dhe përgatitjen e këtij Plani.



PËRMBAJTJA

- I. Hyrje
 - II. Misioni dhe Vizioni
 - III. Metodologjia e ndjekur për përgatitjen e Planit
 - IV. Perpjekjet për të rinjtë në nivel lokal dhe qendror
 - V. Të rinjtë në Pogradec, të dhëna demografike
 - VI. Identifikimi i problemeve, nevojave dhe problemeve të rinisë
 - 1. Arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës;
 - 2. Punësimi dhe sipërmarrja Rinore;
 - 3. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor në politikë dhe vendimarrje;
 - 4. Art, sport, kulturë (hapësira publike për të rinjtë).
 - VII. Matrica e Prioriteteve për të Rinjtë 2025-2028
 - VIII. Buxhetimi i Planit të Veprimit
 - IX. Monitorimi i Zbatimit të Planit të Veprimit
- Bibliografia



**HYRJE, MISIONI DHE
METODOLOGJIA E
DOKUMENTIT
STRATEGJIK**



I. HYRJE

Plani Lokal i Veprimit për Rininë 2025-2028, ka si qëllim avancimin e të gjithë të rinjve dhe të rejave që jetojnë në Pogradec, duke nxitur ndërmarrjen e veprimeve aktive, që synojnë përfshirjen e të rinjve në jetën sociale, politike, ekonomike dhe vendimarrëse. Ky plan synon t'i vendosë të rinjtë dhe të rejat në qendër të vëmendjes të punës dhe përpjekjeve të Bashkisë Pogradec përgjatë 3 viteve të ardhshme, duke i konsideruar ata një komponent të rëndësishëm në avancimin qytetar dhe pjesmarrjes së tyre në vendimarrjen vendore.

Prioritetet/aksionet e propozuara bazuar në këto pika:

- Situatën aktuale të të rinjve në Pogradec;
- Problemet dhe sfidat me të cilat përballet Bashkia e Pogradecit për rritjen e pjesmarrjes së të rinjve në jetën politike, ekonomike dhe sociale;
- Mundësitë dhe vizionin e Bashkisë Pogradec për avancimin e të rinjve, si qytetarë aktivë dhe pjesëmarrës në proceset e ndryshimit të njësive administrative.

Duke i'u referuar numrit të të rinjve dhe nevojave që ata kanë, edhe pse ka ekzistuar Plani Kombëtar për Rininë 2022-2023 po ashtu dhe Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-2029, në Bashkinë Pogradec ka munguar një Plan Lokal Veprimi, dedikuar të rinjve dhe objektiva që priorizojnë nevojat e tyre, në arsim, punësim, shërbime kulturore, sociale dhe rekreative etj.

Problematikat që të rinjtë raportojnë, janë përmbledhur në 4 prioritete kryesore:

1. *Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës;*
2. *Punësimi dhe sipërmarrja rinore;*
3. *Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor në politikë dhe vendimarrje;*
4. *Arti, sporti, kultura dhe mjedisi.*

Pavarësisht përpjekjeve që janë bërë, të rinjtë në Pogradec kanë nevojë për një plan konkret veprimesh, të cilat referojnë shqetësimet, nevojat e tyre dhe synojnë rritjen e standardeve të shërbimeve që fuqizojnë ato. Ky plan do të shtjellohet me objektiva dhe rezultate të prekshme për secilin nga 4 prioritetet e identifikuara. Këto 4 prioritete janë përshkruar shkurtimisht si më poshtë:

Prioriteti 1 - Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës adreson mangësitë fizike dhe materiale si dhe pamundësinë e aksesit në institucione edukuese për shkak të aftësive, përkatësisë në një grup vulnerabël, apo të marginalizuar etj. Gjithashtu janë konsideruar dhe mungesat në nivele të ndryshme të arsimit, si për shembull mos-pasja e bursave për studentët ekselent, mungesa të cilat adresohen në bashkëpunim me Ministrinë e linjës. Ky prioritet përmbledh dhe adreson të



gjitha nivelet e arsimit në territorin e Bashkisë Pogradec. Objektivat dhe masat për këtë prioritet janë ndërtuar duke marrë në konsideratë mundësitë ekzistuese për zgjidhjen e këtyre dhe njëkohësisht duke parashtruar masa që mund të ndërmerren drejt zgjidhjes.

Prioriteti 2 - Punësimi dhe sipërmarrja rinore përfshin dhe adreson papunësinë e të rinjve (duke përfshirë sidomos okupacionet sezonale ose studentore), efektshmërinë e politikave që janë në fuqi për të incentivuar punësimin rinor, si dhe të rinjtë si sipërmarrës. Ky prioritet adreson bashkëpunimin ndërmjet bizneseve, Bashkisë së Pogradecit, vetë përfshirjen e të rinjve dhe palëve të treta si organizata të shoqërisë civile, organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare e më tej.

Prioriteti 3 - Fjesëmarrja dhe përfaqësimi tlinor në politikë dhe vendmarrje merret drejt për së drejti me përfaqësimin e të rinjve për të marrë pjesë në Këshillin Bashkiak si organ përfaqësues i Bashkisë, mundësitë dhe motivimet e të rinjve dhe të rejave për të marrë pjesë direkte në politikbërje dhe vendimmarrje në Pogradec. Në këtë kontekst janë analizuar nisma të mëparshme dhe efektshmëria e tyre, si dhe janë marrë në konsideratë nisma ekzistuese, për të aritur në konkretizimin e masave të sugjeruara.

Prioriteti 4 - Art, sport, kultura dhe mjedisi përfshin dhe adreson kohën e lirë, nevojën për rekreacion dhe të rinjtë virtuoz e të talentuar. Masat janë orientuar drejt krijimit të hapsirave, aktiviteteve dhe programeve si dhe mundësive kulturore si dhe për të ushtruar sportin, për të bërë art dhe aktivitete të tjera krijuese dhe argëtuese.

Për këtë arsye, Bashkia Pogradec ka shfaqur vullnet maksimal, për adaptimin e ndërhyrjeve vertikale me masa dhe prioritete konkrete, që modelojnë një të ardhme më aktive për të rinjtë në qytet duke i konsideruar ata si partnerë në aksionet e qytetit.

II. MISIONI DHE VIZIONI

Misioni i këtij Plan Veprimi është përmirësimi i gjendjes ekonomike, arsimore, sociale, rritja e pjesëmarrjes në vendimmarrje, si dhe fuqizimi i të rinjve që jetojnë, punojnë dhe studiojnë në territorin që i përket Bashkisë Pogradec.

Më specifikisht, ky dokument strategjik, synon:

- Së pari, të identifikojë problemet, nevojat dhe prioritetet e të rinjve të Pogradecit. Kjo është arritur përmes opinioneve të marra nga të rinj në gjimnaze, si dhe NGO-ve e shoqatave rinore, gjatë 1 workshopi në nivel bashkie dhe një workshopi rajonal të zhvilluar në kuadrin e procesit të përgatitjes së kësaj strategjie, gjatë vitit 2024. Një



tjetër kanal informimi për mendimet dhe opinionet e të rinjve kanë qenë tre studime dhe raporte kombëtare për rininë shqiptare të organizatës CRCA/ECPAT Shqipëri dhe Rrjetit Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri - ANYN.

- Së dyti, të propozojë zgjidhjet e mundshme ose fushat e ndërhyrjes, nëpërmjet mënyrave, mekanizmave dhe mjeteve të caktuara, për të adresuar problematikat e dala.

Planit Lokal i Veprimit për të Rinjtë fokusohet në periudhën 2025 - 2028.

III. METODOLOGJIA E NDJEKUR PËR PËRGATITJEN E PLANIT

Procesi i hartimit të Planit Lokal të Veprimit të Bashkisë Pogradec për të Rinjtë, filloi në nëntor 2023 dhe vijoi deri në muajin shtator 2024. Metodologjia e ndjekur për hartimin e Plan Veprimit konsiston në 6 etapa të ndryshme. Ky Plan Veprimi është realizuar me përfshirje të gjerë të vetë të rinjve, si dhe me pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm të cilët kanë të bëjnë me realizimin e 4 (katër) prioriteteve të identifikuar. Për të arritur në rezultatet e këtij Plan Veprimi është aplikuar një metodologji mikse ku përfshihen rishikim literature për sa i përket modeleve të suksesshme të plan veprimeve të ngjashme, intervista gjysëm të strukturuar dhe takime me aktorët kyç. Këto etapa janë zhvilluar në rend kronologjik, pasi etapa pararendëse është kusht përmbushës për atë që pason.

Etapat e metodologjisë përfshijnë:

1. ETAPA 1-Faza përgatitore;
2. ETAPA 2-Identifikimi i prioriteteve;
3. ETAPA 3-Bashkëpunimi me institucione dhe drejtori të Bashkisë Pogradec;
4. ETAPA 4-Konsultim me përfaqësuesit e Bashkisë Pogradec;
5. ETAPA 5-Prezantimi publik;
6. ETAPA 6-Aprovimi nga Bashkia dhe Këshilli Bashkiak.

ETAPA 1 - Faza përgatitore, përfshin hartëzimin e të gjithë punës për ndërtimin e këtij plan veprimi. Si fillim u realizuar përfshirja e të rinjve për identifikimin e nevojave, shqetësimeve dhe problematikave të tyre. Të rinjtë e përfshirë përbëhen nga nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në qytetin e Pogradecit, përfaqësues të organizatave dhe grupimeve rinore si dhe përfaqësues të Këshillit Rinor Vendor në qytetin e Pogradecit. Këto të rinj nën facilitimin e ekspertëve përgjegjës për këtë proces janë përfshirë në të gjithë etapat e ndërtimit të këtij Plan Veprimi. Në këtë fazë është ndërtuar dhe axhenda e takimeve dhe intervistave, si dhe kërkimi për literaturën dhe materialeve të tjera të nevojshme.



ETAPA 2 - Identifikimi i prioritetëve përfshinte takime dhe konsultime me të rinjtë e përfshirë në këtë proces për të identifikuar hapat konkret të planit të veprimit. Ekspertët që facilituan këtë proces u ofruan dhe trajnim të rinjve të përfshirë në mënyrë që mund të arrinin në artikullimin më të mirë të nevojave të tyre. Në këtë mënyrë duke bërë dhe një Analizë SWOT, pra duke parë pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe mangësitë që të rinjtë kanë në Pogradec u arritën në artikullimin e 4 (katër) prioritetëve kryesore. Nevojat e tyre janë të grupuara në këtë mënyrë, duke adresuar dhe zgjidhjet e mundshme dhe aktorët që janë përgjegjës për këto zgjidhje. Bashkë me të rinjtë është përpiluar drafti i parë i Plan Veprimit.

Përgjatë procesit të hartimit, janë përfshirë mbi 100 të rinj dhe të reja, përfaqësues të organizatave rinore të shoqërisë civile nga të nëntë njësitë administrative të Pogradecit, ku nëpërmjet 1 workshopi në nivel bashkie adresuan së bashku prioritetet dhe masat e përfshira në këtë plan. Ndërkohë, krahas të rinjve dhe organizatave rinore përgjatë muajit Mars 2024 u zhvillua një workshop rajonal ku përkrah të rinjve dhe të rejave u bënë pjesë edhe përfaqësues të Bashkisë Pogradec, ku u konsultuan gjërësisht prioritetet dhe problematikat e adresuara dhe të ngritura nga vetë të rinjtë në Pogradec.

ETAPA 3 - Bashkëpunimi me Institucione dhe drejtorit të Bashkisë Pogradec, në këtë fazë janë lidhur secili nga 4 prioritetet të identifikuar me të rinjtë, përaktësisht me secilën nga institucionet apo drejtoritë e Bashkisë Pogradec. Dy ekspertët, për këtë kanë realizuar një varg takimesh me persona përgjegjës në institucionet apo drejtoritë përkatëse. Në këto takime janë konsultuar 4 prioritetet që të rinjtë kanë identifikuar si dhe zgjidhjet e propozuara. Ndërkaq janë vrojtuar dhe politikat, mangësitë si dhe janë eksploruar opsione të mundshme në bashkëpunim me institucionet apo drejtoritë përkatëse në mënyrë që të adresohet realizimi konkret i 4 prioritetëve të identifikuar nga të rinjtë. Përfundimet e këtyre takimeve dhe intervistave janë reflektuar nga ekspertët në draftin e Plan Veprimit.

ETAPA 4 - Konsultim me përfaqësuesit e Bashkisë Pogradec, drafti i këtij Plan Veprimi, i cili është përpiluar gjatë këtyre fazave është konsultuar dhe me këshilltarë të Këshillit Bashkiak Pogradec. Janë marrë komente dhe sugjerime prej tyre dhe më pas janë reflektuar në një version të dytë draft të këtij Plan Veprimi.

ETAPA 5 - Prezantimi publik, me anë të një eventi publik dhe të hapur për të gjithë është prezantuar draft i Plan Veprimit. Të rinjtë pjesëmarrës në këtë proces dhe përfaqësues nga Bashkia Pogradec kanë qënë prezent në këtë event. Në këtë etapë është marrë feedback nga një audiencë e gjërë. Ky feedback është kthyer në komente e sugjerime, të cilat janë reflektuar në versionin final që do i paraqitet kryetarit të Bashkisë Pogradec dhe Këshillit Bashkiak të Pogradecit.



ETAPA 5 - Aprovimi nga Bashkia dhe Këshilli Bashkiak, në këtë fazë Plan Veprimi në formën e një versioni final i dorëzohet Sektorit të Turizmit dhe Rinisë në Bashkinë e Pogradecit. Kjo drejtori më pas i'a dorëzon Kryetarit të Bashkisë Pogradec dhe Këshillit Bashkiak të Pogradecit për aprovim. Pasi kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak e shqyrton në mbledhjen e tij ose në një formë tjetër, përcaktohet aprovimi dhe versioni final i këtij Plan Veprimi.

Partnerët janë komponent shumë i rëndësishëm i një strategjie, së pari sepse cilësia e tyre ndikon direkt në cilësinë e produktit, dhe së dyti gjithanshmëria e tyre (pra një gamë e gjerë aktorësh të përfshirë në proces), e bën produktin më të besueshëm dhe cilësor. Në procesin e hartimit të kesaj strategjie janë përfshirë partnerët e mëposhtëm:

- Autoritetet e pushtetit vendor: Bashkia e Pogradecit (me specifikisht Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë, Qendra Arsimore, Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar, Njësia për Integrimin Europian, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Ndërmarrja e Parqeve dhe Rekreacionit, Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike, Drejtoria e Shërbimit të Pyjeve dhe Kullotave.)¹ dhe 9 Njesitë Administrative.
- Organizatatat, grupimet dhe këshillat rinore që operojnë në nivel lokal dhe qendror: Këshilli Rinor Vendor Pogradec, Këshilli Rinor Pogradec, Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri (ANYN), Këshilli Rinor Kombëtar - KRK.
- Ofruesit e shërbimeve për rininë (Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë, Qendra Arsimore, Njësia për Integrimin Europian).

¹ Organigrama e Bashkisë Pogradec, lidhja në linkun vijues: <https://bashkiapogradec.gov.al/faqe/organigrama-e-bashkise-ue-pogradecit-9/>



**PËRPJËKJET PËR TË
RINJTË NË NIVEL
VENDOR DHE
QËNDROR**

IV. PERPJEKJET PËR TË RINJTË NË NIVEL VENDOR DHE QËNDROR

Në Shqipëri, periudha 2013-2024 ka parë zhvillime të rëndësishme në kuadrin ligjor dhe strategjitë për të rinjtë. Këto përpjekje synojnë të adresojnë nevojat e rinisë dhe të ofrojnë mbështetje në fusha të ndryshme si arsimi, punësimi, shëndeti dhe pjesëmarrja në jetën shoqërore dhe politike. *Më poshtë është një përmbledhje e kuadrit ligjor, institucional dhe strategjive kryesore për të rinjtë në nivel qendror gjatë kësaj periudhe:*

1. KUADRI LIGJOR

1.1. LIGJI PËR RININË²

Përgjatë pesë vjeçarit të fundit një hapësirë të madhe zuri procesi i draftimit, miratimit dhe zbatimit të *Ligji Nr. 80/2015 "Për Rininë"*. Objekti i këtij ligji është mbrojtja e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimi i kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, përcaktimi i funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, si dhe bashkëpunimi me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i veprimtarive, mekanizmave dhe autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në Republikën e Shqipërisë dhe të të rinjve shqiptarë në diasporë, si dhe financimin e veprimtarive rinore, në kuadër të së drejtës së të rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti.

Pesë vite nga miratimi, hyrja në fuqi dhe zbatimi i Ligjit për Rininë, marrë shkas nga disa mangësi të theksuara që po shfaq zbatimi i tij, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka iniciuar një proces të gjerë konsultimi me të rinj e të reja, përfaqësues të organizatave rinore dhe atyre për të rinjtë, përfaqësues të institucioneve publike vendore dhe qendrore, për kryerjen e ndryshimeve përkatëse të nevojshme.

1.2. LIGJI PËR ARSIMIN

Ligji Nr. 69/2012 "Për Arsimin Parauniversitar".³ Ky ligj ka si qëllim përmirësimin e cilësisë së arsimit të mesëm dhe orientimin e tij për të përmbushur nevojat e tregut të punës dhe të rinisë.

² Ligji Nr. 75-2019 "Për Rininë", lidhja në linkun vijues: <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/12/Përmbledhje-e-ligjit-dhe-akteve-n%C3%ABnligjore-n%C3%AB-fush%C3%ABn-e-rinis%C3%AB.pdf>

³ Ligji Nr. 69/2012 "Për Arsimin Parauniversitar", lidhja në linkun vijues: https://www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/Ligji_Parauniversitar.pdf



Më konkretisht, objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve bazë për strukturën, veprimtarinë dhe qeverisjen e sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. Ndërsa, qëllimi i këtij ligji është garantimi i së drejtës kushtetuese për arsimim, sipas kuartrit ligjor përkatës për funksionimin e sistemit arsimor parauniversitar.

Fusha e zbatimit të këtij ligji është sistemi arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, përveç aspekteve të strukturës, veprimtarisë dhe qeverisjes së arsimit profesional, që rregullohen me ligj të veçantë.

Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Arsimin e Lartë"⁴: Ky ligj ka si qëllim të reformojë arsimin e lartë, përmirësojë cilësinë e tij dhe lidhjen e tij me kërkesat e tregut të punës.

Më konkretisht, ky ligj synon të:

- a) të përcaktojë rolin e shtetit në arsimin e lartë;
- b) të përcaktojë misionin, objektivat kryesorë të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, rregullat e financimit dhe mbylljes të institucioneve të arsimit të lartë;
- c) të krijojë një sistem të unifikuar të arsimit të lartë, kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë, inovacionit bashkëkohor e konkurrues në hapësirën europiane të arsimit të lartë;
- ç) të krijojë mekanizma të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me standardet europiane;
- d) të vendosë arsimin e lartë mbi baza të qëndrueshme financiare, duke krijuar mundësinë për shfrytëzimin e burimeve të ligjshme të financimit;
- dh) të garantojë mundësi të barabarta, mbi bazën e meritës, për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në arsimin e lartë;
- e) të bazojë sistemin e arsimit të lartë mbi parimin e konkurrencës së lirë mes institucioneve të arsimit të studentëve.

1.3. LIGJI PËR PUNËSIMIN

Ligji Nr. 15/2019 "Për Nxitjen e Punësimit"⁵: Ky ligj synon të ofrojë një kuadër për mbështetje dhe nxitje të punësimit, duke përfshirë mundësi për trajnime dhe zhvillimin e aftësive të rinisë. Ky ligj përcakton rregullat dhe mënyrën e funksionimit të sistemit publik të shërbimeve të

⁴ *Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Arsimin e Lartë"*, lidhja në linkun vijues: https://uniilr.edu.al/eng/wp-content/uploads/2019/08/Ligji_80-2015_22.07.2015.pdf

⁵ *Ligji Nr. 15/2019 "Për Nxitjen e Punësimit"*, lidhja në linkun vijues: <https://akpa.gov.al/wp-content/uploads/2019/05/ligj-nr-15-dt-13.3.2019-nxitja-e-punesimit.pdf>



punësimit, të programeve aktive e pasive të tregut të punës, si dhe organet përgjegjëse për menaxhimin e tyre, me përjashtim të rasteve kur rregullohen nga legjislacioni i posaçëm. Ligji ka për qëllim rritjen e punësueshmërisë së forcave të punës, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve dhe programeve publike të punësimit, të vetëpunësimit dhe të kualifikimit profesional.

1.4. LIGJI PËR SHËNDETIN

*Ligji Nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor"*⁶: Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen më të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime të shëndetit mendor. Ligji përcakton procedurën dhe kushtet për mbrojtjen e shëndetit mendor, nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor, sigurimit të një mjedisi social të përshtatshëm për personat me çrregullime të shëndetit mendor dhe nëpërmjet politikave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor.

1.5. LIGJI PËR SHËRBIMET E KUJDESIT SHOQËROR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

*Ligj Nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë"*⁷: Ky ligj ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

Shërbimet e kujdesit shoqëror janë të organizuara si shërbime në komunitet, institucione të kujdesit dhe familje për të gjitha kategoritë e identifikuar të përfituesve. Llojet e shërbimeve shoqërore janë si më poshtë:

- a) shërbimet parashoqërore;
- b) shërbimet në qendrat komunitare, përfshirë qendrat e zhvillimit;
- c) shërbimet në qendrat rezidenciale, përfshirë strehëzat;
- ç) shërbimet shoqërore në situatë emergjence;
- d) shërbimet e kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror;
- dh) shërbimet e specializuara;
- e) shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line.

⁶ Ligji Nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor", lidhja në linkun vijues: https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Ligji_Nr.44_2012_per_shendetin_mendor.pdf

⁷ Ligj Nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", lidhja në linkun vijues: <https://qbz.gov.al/elli/ligji/2016/11/24/121-2016>



Shërbimet e kujdesit shoqëror janë shërbime rezidenciale kur është i pashmangshëm dhe i papërshtatshëm ofrimi i tyre në familje apo komunitet.

2. POLITIKAT, PROGRAMET DHE STRATEGJITË KOMBËTARE

2.1. STRATEGJIA KOMBËTARE PËR RININË 2015-2020

Në 6 Maj 2015, Qeveria Shqiptare miratoi Planin Kombëtar të Veprimit për të Rinjtë (2015-2020), pas një përpjekje të gjerë të konsultimit me organizatat dhe të rinjtë në Shqipëri. Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri (ANYN) luajti një rol aktiv në përgatitjen, rishikimin dhe konsultimin e Planit të Veprimit me të rinj e të reja dhe organizatat anëtare të saj. Planit caktoi një sërë detyrash për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, institucionet në varësi të saj, ministrinë e tjera të linjës dhe bashkitë, të cilat janë përgjegjëse për arritjen e objektivave të tij. Planit kishte si objektiv dhe fusha kryesore të zbatimit si vijim:

- **Objektiva:** Të përmirësojë cilësinë e jetës së rinisë, të nxisë pjesëmarrjen e tyre në shoqëri dhe të ofrojë mundësi për zhvillimin e aftësive dhe karrierës.
- **Fushat Kryesore:** Arsimimi dhe formimi profesional, punësimi, shëndeti, pjesëmarrja në proceset vendimmarrëse dhe angazhimi në aktivitete kulturore dhe sportive.

Referuar Raportit Kombëtar "Rinia në Shqipëri 2019", ky plan është zbatuar në një masë tepër të vogël të tij, ku deri në fundin e vitit 2017 kishte arritur deri në masën 21%. Aktualisht që flasim ende nuk dihet zyrtarisht se sa është vlera e vërtetë e zbatimit të këtij plani, sepse nuk ka një raport monitorues nga vetë Ministria përkatëse që ka qenë përgjegjëse për zbatimin e tij.

Mungesa e Programit Buxhetor për të Rinjtë në buxhetin e përgjithshëm të Ministrisë, ka ndikuar në mos-përbushjen e indikatorëve të matjes së zbatimit, duke rritur së tepërmi mundësitë që Planit Kombëtar të dështonte në zbatimin e tij. Mungesa e një skeme financimi të rregulluar me Ligj për mbështetjen e OSHC-ve të të rinjve dhe forumeve politike, pengoi zbatimin e Planit të Veprimit, pasi organizatat, si agjentë të ndryshimit, nuk mundën të angazhohen në mënyrë efektive për të zbatuar një apo disa elemente të Planit Kombëtar për të Rinjtë.

Pesë vite pas miratimit të Planit, asnjë Raport Monitorimi apo Vlerësimi nuk është përgatitur nga Qeveria për zbatimin e PKV-së! Mungesa e monitorimit dhe vlerësimit 6 mujor dhe atij vjeçar të Planit, përbushjes së indikatorëve dhe realizimit të aktiviteteve të parashikuara, mungesa e kërkesë-llogarisë brenda vetë Ministrisë, matjes së performancës së stafit të zyrave respektive, krijuan një vakum të shtrirë në kohë të mos-zbatimit të Planit Kombëtar për të



Rinjtë në Shqipëri. Si rezultat, thuhet se 5 vjet pas miratimit të Planit, asnjë Raport Monitorimi apo Vlerësimi nuk është përgatitur nga strukturat e ngarkuara me këtë funksion.

2.2. STRATEGJIA KOMBËTARE E RINISË DHE PLANI I VEPRIMIT 2022-2029

Në vijim të Ligjit nr. 75/2019 "Për Rininë", i cili siguron bazën ligjore për hartimin e politikave dhe programeve strategjike për rininë, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në bashkëpunim me anëtarët e grupit të punës ndërministror, kanë hartuar Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, si dhe Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029.

Sikurse cituar në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022 – 2024 (faqe 408), se: *"Strategjia Kombëtare për Rininë 2022 – 2029 do të jetë dokumenti ku do të bazohen politikat për aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve. Ky dokument do të synojë hartimin e politikave rinore kombëtare integruese, për adresimin e problemeve të ndryshme me të cilat përballen sot të rinjtë e që lidhen me sfida si, përfshirja e tyre në proceset vendimmarrëse, punësimi, edukimi, teknologjia dhe inovacioni, rritja e aktiviteteve në lidhje me artet dhe zejet, shtim të aktiviteteve sportive, vullnetarizëm etj. Strategjia Kombëtare për Rininë 2022 – 2029 do të jetë në përputhje me Strategjinë Evropiane për Rininë 2019 – 2027."*

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 është e para strategji e dedikuar për rininë në Shqipëri, duke i dhënë kaq fokus dhe rëndësi rinisë, edukimit, talenteve të tyre dhe kërkesave që ata kanë në fusha të ndryshme.

Në bashkëpunim me të rinjtë anë e kënd Shqipërisë, është konceptuar dhe hartuar Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-2029, e para strategji 8 vjeçare, që përfshin të gjitha masat dhe projektet që do të ndërmerren, me qëllim krijimin e një Shqipërie më të mirë për të rinjtë. Strategjia e Rinisë 2022-2029 është krijuar në thelb nga vetë të rinjtë nëpërmjet një procesi konsultimi të organizuar në disa faza që ka zgjatur nga gushti i vitit 2021 deri më shkurt të vitit 2022, ku ata ngritën shqetësimet e tyre, duke i thënë problematikat që kanë në përditshmëri në zonat ku jetojnë. Ata shprehën idetë dhe mendimet që mund t'ju japin zgjidhje kërkesave të tyre.

Politika kombëtare e strategjisë së rinisë dhe përpjekjet programuese përqendrohen në sigurimin e barazisë së mundësive dhe të drejtave, mbështetjes dhe angazhimit për të rejtat dhe të rinjtë që janë më të prekshëm, të marginalizuar dhe më të goditur nga mungesat e shumta, të tilla si varfëria, dhuna, keqtrajtimi, paaftësia dhe përjashtimi social. Kjo strategji synon të orientojë rininë shqiptare për veprim të mëtjetshëm i cili ndikon pozitivisht në të ardhmen e tyre.



Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 ka tre qëllime politike:

- Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financiar.
- Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.
- Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social.

Strategjia e Rinisë synon të përmirësojë situatën e të rinjve në Shqipëri duke u ofruar mundësi të barabarta me të rinjtë europianë, duke u krijuar mundësi për arsim cilësor dhe përfshirje në tregun e punës shqiptar dhe atë ndërkombëtar.⁸

2.3. STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIMIN E ZGJERUAR DHE INTEGRIMIN 2015-2020

Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin 2015-2020 (SKZHI II) është dokumenti themelor strategjik që kombinon agjendën e integrimit në Bashkimin Evropian me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit, përfshirë edhe ndërlidhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Strategjia përcakton vizionin për Shqipërinë si "...demokraci në forcim, në rrugën e saj drejt integrimit në Bashkimin Evropian, me një ekonomi konkurruese, të stabilizuar e të qëndrueshme dhe me garanci për të drejtat themelore dhe liritë themelore të njeriut".

Kjo strategji ka një pike të veçantë, 11.9 e cila lidhet me fuqizimin e rinisë përballë këtyre sfidave:

- *Nevojën për më shumë pushtet ekonomik rinor përmes programeve të nxitjes së punësimit, arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale;*
- *Nevojën për krijimin e kapësirave publike për t'iu shërbyer të rinjve;*
- *Fuqizimin e kapaciteteve të organizatave rinore;*
- *Krijimin e rrjeteve rinore, këshillave të qarqeve dhe komisioneve kombëtare të konsultimit për çështjet rinore; dhe*
- *Nevojën për rritjen e pjesëmarrjes aktive të rinjve në komunitet dhe programeve ndër-rajonale.*

⁸ "Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe Plani i Veprimit 2022-2029", lidhja në linkun vijues: <https://ninafemijet.gov.al/dokumentet/kombetare-e-rinise-2022-2029-tashme-miratuar/>



Kjo strategji paraqet si vizion: "Një rini aktive dhe me barazi në të gjitha fushat e jetës shoqërore, e shëndetshme, e arsimuar dhe me një status të konsoliduar në shoqëri" duke u bazuar te aktivizmi i saj dhe barazia në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Rinia vizionohet si e shëndetshme, e arsimuar dhe me një status të konsoliduar në shoqëri.

Në këtë dokument parashtrihen edhe këto objektiva strategjike:

- *Mbështetja dhe integrimi i të rinjve në tregun e punës, si punëmarrës dhe sipërmarrës;*
- *Nxitja dhe thellimi i pjesëmarrjes së të rinjve në shoqëri, vendimmarrje dhe mirëqenie; dhe*
- *Forcimi i arsimit dhe formimit profesional për të rinjtë në të gjitha nivelet dhe shtimi i mundësive për të mësuar gjatë gjithë jetës;*

Të lidhura ngushtë me rininë janë edhe pjesë të tjera të kësaj strategjie shtyllat 2, 3 dhe 4 që kanë të bëjnë me rritjen ekonomike përmes konkurrueshmërisë dhe novacionit, investimin në kapital njerëzor dhe kohezionin social, si edhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve dhe zhvillimit të territorit.

2.4. PLANI KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN (PKIE) 2022-2024

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2022-2024 thekson se: Ideja e hartimit të Strategjisë Kombëtare për Rininë 2022-2029 vjen si një domosdoshmëri jo vetëm me miratimin e Ligjit nr. 75/2019 "Për Rininë", por edhe për faktin se në dhjetor 2020 ka përfunduar "Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020". Në këtë mënyrë ky plan e vendos si prioritet të tij rininë si edhe miratimin e kësaj strategjie brenda tremujorit të tretë të këtij viti. Më gjerësisht çështjet me rininë si grup i caktuar shoqëror me interesa dhe nevoja të veçanta trajtohen në kapitullin 26 (fq.400), kapitull i cili në tërësinë e vet përfshin çështje të rëndësishme për rininë siç janë arsimit dhe kultura.

Çështjet që kanë të bëjnë me rininë ky plan i shikon edhe në aspektin e bashkëpunimit dhe integritit rajonal dhe tema si "Investimi te Rinia në të Ardhmen Evropiane" kanë marrë prioritet në proceset e asociim stabilizimit dhe integritit me Bashkimin Evropian. Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 524, datë 22.9.2021, "Rinia" tashmë është fushë e përgjegjësisë së Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, për pasojë dhe puna për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë ka kaluar në këtë ministri.

Përveç trajtimit të çështjeve ikonike të rinisë që lidhen me përmirësimin e cilësisë në arsim, mundësitë praktike për të vënë në zbatim dijet e marra, këshillimin për karrierë dhe argëtimin



larg veseve dhe praktikave jo të ligjshme, ky plan ka prerje me strategjinë edhe në këto fusha të tjera të veprimit të tij:

- *Programi Kombëtar i Praktikave të Punës.*
- *Programi kombëtar "Edukimi për artet dhe zejet në institucionet arsimore parauniversitare".*

2.5. STRATEGJIA E DREJTËSISË PËR TË MITUR DHE PLANI I VEPRIMIT 2018-2021⁹

Mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të të miturve është një ndër prioritetet kyçe të Ministrisë së Drejtësisë, e jetësuar në Programin e Qeverisë Shqiptare nën objektivin madhor: "Zbatimi i reformimit të sistemit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin, duke forcuar sistemin e drejtësisë restauruese dhe mbrojtjen efektive procedurale".

Ministria e Drejtësisë, mbështetur në kuadrin ligjor vendës dhe ndërkombëtar që rregullon fushën e të drejtave të fëmijëve vlerëson se interesi më i lartë i fëmijës është një parim i rëndësishëm, i cili duhet të gjejë zbatim së pari në të drejtën penale, por edhe atë administrative dhe civile. Ky vlerësim gjen konkretizim në angazhimin për hartimin dhe finalizimin e një dokumenti të nevojshëm politikash për të miturit në konflikt me ligjin, të shoqëruar më një plan veprimi me prioritete, objektiva, masa dhe indikatorë gjithëpërfshirës, të matshëm dhe që kanë impakt të plotë në përmirësimin e të gjithë sistemit të drejtësisë që trajton çështjet e të miturve. Mbrojtja e të drejtave të të miturve nëpërmjet garantimit të ofrimit të shërbimeve në sistemin gjyqësor ka qenë një nga rregullimet bazë të paketës më të fundit ligjore të normimit të sistemit të drejtësisë, në kuadër të reformës në drejtësi. Konkretisht, të miturit në sistemin e drejtësisë penale përbëjnë një kategori vulnerabël dhe garantimi i procedurave ligjore të shpejta, efektive dhe cilësore ka qenë synimi më i rëndësishëm i reformës në sistemin e drejtësisë penale, e konkretizuar kjo me miratimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe Ligjin për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, si edhe një sërë normash të tjera materiale e procedurale.

Kjo paketë ligjore, lidhur me të drejtat e të miturve, ka pasur në fokus përmirësimin e mëtejshëm të përmbajtjes dhe formës në mënyrën e trajtimit të të miturve në sistemin gjyqësor, si dhe trajtimin e specializuar që u ofrohet të miturve në komunitet, duke ofruar mbështetje nga njëra anë subjektit të veprës penale që në këtë rast është i mitur dhe nga ana tjetër edhe viktimës dhe dëshmitarit të mitur. Ndër të tjera, fasha e mbrojtjes ligjore është zgjeruar, duke përfshirë në këto rregulla edhe të rinjtë deri në moshën 21 vjeç.

⁹ VENDIM Nr. 541, datë 19.9.2018 PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË DREJTËSISË PËR TË MITUR DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT 2018-2021, lidhja në linkun vijues: <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/Strategjia-e-Drejtësisë-për-të-Mitur-PV-2018-2021-miratuar-VKM-nr.541-dt.19.9.2018.pdf>



Për sa më sipër, si dhe në vazhdim të detyrimit institucional për garantimin e të drejtave të të miturve, u hartua dokumenti politik "Strategjia e drejtësisë për të mitur", i shoqëruar me planin e veprimit për periudhën afatgjatë 2018–2021. "Strategjia e Drejtësisë për të Mitur", i shoqëruar me Planin e Veprimit për periudhën afatgjatë 2018–2021, miratuar me VKM Nr. 541, date 19.09.2018. Risi e reformës së drejtësisë penale për të mitur janë dhe institucionet e reja, si Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR), si dhe Instituti Multidisiplinor i të Miturve.

3. POLITIKAT DHE PLANET NË NIVEL LOKAL NË POGRADEC

3.1. PLANI SOCIAL, BASHKIA POGRADEC (2019-2023)³⁰

Plani i Kujdesit Social është hartuar nga Bashkia Pogradec në konsultim me përfaqësues të institucioneve vendore dhe shoqërisë civile, me mbështetjen teknike të Fondacionit "Ndihmë për Fëmijët" në kuadër të Programit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Askush Të Mos Mbetet Pas" që financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatohet nën mbikëqyrjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, UNDP.

Plani Kujdesit Social është bazuar në qasjen e ofrimit të një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë si dhe në filozofinë e ndërtimit të partneritetit midis aktorëve të ndryshëm, si institucionet e qeverisjes vendore dhe rajonale, organizatat ndërkombëtare, kombëtare dhe ato lokale, si dhe biznesin vendor si një mbështetës potencial në fuqizimin e shërbimeve sociale. Ai u shoqërua gjithashtu me Planin e Veprimit (2019-2023) i cili është i ndarë në katër fusha kryesore:

1. Koordinimi dhe rrjetëzimi i shërbimeve;
2. Ngritja e kapaciteteve të strukturave dhe burimeve njerëzore;
3. Zhvillimin e shërbimevesociale në Bashkinë e Pogradecit;
4. Programet parandaluese;

Në zbatim të vizionit të saj, Bashkia Pogradec përmes zbatimit të këtij plani synonte të garantonte zhvillimin e qëndrueshëm të territorit duke siguruar një kohezion social ndërmjet të gjithë grupeve të qytetarëve pavarësisht statusit social të tyre. Ky vizion, i kthyer në priorite lokale, përcolli qëllimin dhe një sërë objektiva specifike, si vijon:

³⁰ Plani i Mbrojtjes Sociale, Bashkia Pogradec 2019 – 2023, lidhja në linkun vijues:
<https://bashkiapogradec.gov.al/ngarkime/njoftimet/docs/190820201504-plani-i-mbrojtjes-sociale.pdf>



1. *Bashkia Pogradec do të ndërmarrte nisma që përmirësonin strukturat administrative të shërbimeve sociale, përfshirë planifikimin, ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve në të gjithë territorin e bashkisë.*
2. *Bashkia Pogradec do të mbështeste fuqizimin e decentralizimit, në funksion të efijencës së dhënies së shërbimeve cilësore për qytetarët, familjet dhe komunitetet në nevojë. Ndër të tjera, këtë gjë do ta realizonte duke rritur autonominë financiare dhe modernizuar shërbimet sociale. Bashkia do të merrte rolin e zhvilluesit apo promotorit të ofrimit të shërbimeve në territor.*
3. *Bashkia do të garantonte parimin e barazisë duke u fokusuar veçanërisht tek nevojat me emergjente për shërbime sociale.*
4. *Bashkia do të punonte, për të prezantuar një tërësi instrumentesh në funksion të fuqizimit të kapitalit njerëzor dhe integritit të tij në ekonominë vendore dhe në zhvillimin e territorit.*

3.2. QENDRA E SHËRBIMEVE RINORE ME NJË NDALESË NË QARKUN E KORÇËS

Studime dhe raporte të rëndësishme të kryera në vende të ndryshme të Bashkimit Europian mbi analizimin e shërbimeve ekzistuese rinore, adresojnë faktin se të rinjtë vendosin një theks të madh në shërbimet ballë për ballë krahasuar me ato të ofruara online. Të rinjtë në këto vende i kanë konsideruar shërbimet elektronike/online, si ndihmuese për një mbështetje të përgjithshme, ndërsa për çështje të rëndësishme dhe specifike preferojnë që ky shkëmbim informacioni dhe mbështetje të bëhet personalisht me një specialist të fushës respektive.

Një ndër sfidat me të cilat të rinjtë në Europë janë përballur ndër vite dhe që të rinjtë në Shqipëri po përballen sot, është ekzistenca e një numri të konsiderueshëm shërbimesh të integruara me në fokus fuqizimin e tyre, por të fragmentuara! Në këtë pikë nëse një i ri ose e re ka shumë çështje për të diskutuar, i duhet që të zhvillojë takime të shumta në zyrë të ndryshme me ekspertë të ndryshëm. Kjo do të thotë që asnjë ofrues shërbimi për të rinjtë nuk ka një pasqyrë holistike të situatës së klientit në të gjitha aspektet e jetës së tij.

Në vende të ndryshme të Bashkimit Europian, si për shembull Finlanda kjo sfidë e hershme e të rinjve ka marrë zgjidhje përmes zhvillimit dhe zbatimit të idesë për krijimin e Spoerteleve, Qendrave Udhëzuese me një Ndalesë në ndihmë të të rinjve. Në Finlandë, Qendra e parë Udhëzuese me një Ndalesë u hap në vjeshtën e vitit 2014 si pjesë e zbatimit të Garancisë Rinore në këtë shtet. Kjo praktikë më pas u përhap në mbarë vendin, duke sjellë idenë e partneritetit privat-publik në nivelet lokale dhe rajonale. Qëllimi i këtyre Qendrave Udhëzuese me një Ndalesë ishte që të përmblihte të gjitha shërbimet e nevojshme, mbështetëse dhe fuqizuese për të rinjtë në një vend, me fokus në udhëzimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës.



Përsa më sipër, për të përmbushur mungesën e këtyre shërbimeve mbështetëse komunitare për të rinjtë në Shqipëri, CRCA/ECPAT Shqipëri përgjatë vitit 2023-2024, me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Ministrisë së Shtetit për të Rinjtë dhe Fëmijët zbatuan dhe pilotuan për herë të parë modelin e Qendrës së Shërbimeve Rinore me një Ndalesë në Bashkinë e Korçës, Pogradecit, Maliqit dhe Devollit.

Qendra e Shërbimeve Rinore me një Ndalesë është një shërbim model unik, që sjell në një vend të vetëm të gjitha shërbimet publike dhe ato të OSHC-ve për të rinjtë dhe të rejtat, për të promovuar kujdesin, mbështetjen dhe fuqizimin e të rinjve për një jetë, punësim dhe karrierë të suksesshme. Qendra është një zyrë me një ndalesë që synon të drejtojë dhe mbështesë të rinjtë dhe të rejtat banues në territorin e Bashkive Pogradec, Maliq, Korçë dhe Devoll, në rrugën e tyre nga moshën e arsimit bazë deri në moshën madhore. Qendra drejtohet nga të rinjtë për të rinjtë synon të fuqizojë të rinjtë e grupeve më në nevojë dhe të krijojë një mjedis gjithëpërfshirës që i ndihmon ata të kapërcejnë pengesat që lidhen me arsimin dhe aksesin në tregun e punës. Kjo qendër u hap në Bashkinë Korçë – për shkak sepse shërbimet në nivel qarku janë të vendosura në këtë qytet, por që funksionon si një zyrë koordinuese për të gjithë të rinjtë në të katër bashkitë e këtij qarku.

Në fokus të ndërhyrjes, veprimtarisë dhe shërbimeve të Qendrës janë të rinjtë e të rejtat për të fuqizuar kapacitetet e tyre në arsimin joformal, informim dhe garantim të aksesit në shërbimet me bazë komunitare si dhe orientimin e tyre drejt tregut të punës për të hedhur hapa drejt një të ardhme më të qëndrueshme në zonën ku ata jetojnë. Qendra referon të rinjtë në shërbimet shoqërore, ato të shëndetit mendor, të karrierës apo të kualifikimit të mëtejshëm, të internshipeve në organizata etj., pra duke u kthyer në një qendër ku çdo i ri gjen aty shërbimet që i nevojiten. Kjo do të shoqërohet edhe nga një platformë online, për shkak se të rinjtë përdorin gjerësisht teknologjinë shumicën e kohës.

Objektivi kryesor i Qendrës së Shërbimeve Rinore me një Ndalesë është të bashkojë ofrues të ndryshëm shërbimesh nga sektori privat, publik dhe i tretë në një vend, për të krijuar një platformë ku të gjithë ata mund të operojnë. Ajo ofron një qasje gjithëpërfshirëse për integrimin e të rinjve në shoqëri, arsim dhe tregun e punës duke ofruar informacione, këshilla, udhëzime dhe mbështetje shumë-sektoriale duke përdorur një rrjet të gjerë partnerësh në të gjithë sektorët.

Qendra ofron shërbime për një gamë të gjerë individësh të rinj, shpesh duke synuar ata të grupmoshës 15 deri në 29 vjeç. Megjithatë, kriteret e përshtatshmërisë për marrjen e shërbimeve mund të ndryshojnë në varësi të burimeve të saj të financimit dhe programeve të ofruara.

Disa prej grupeve kryesore të të rinjve që mund t'i drejtohen Qendrës së Shërbimeve Rinore me një Ndalesë për të marrë shërbimet e ofruara janë si vijim:



- ✓ *Të rinjtë në nevojë:* Të rinjtë që përballen me sfida të tilla si mungesa e një strehimi, përfshirja në sistemin e drejtësisë, çështjet e abuzimit me substancat, shqetësimet e shëndetit mendor ose ata që përjetojnë vështirësi familjare ose sociale. Në këtë drejtim përfitues të qendrës janë të gjithë të rinjtë e të reja në nevojë nga shtresa të ndryshme të marginalizuara si komuniteti rom/egjiptian, të rinjtë e të reja me aftësi të kufizuara, të rinjtë e të reja LGBTI, si dhe të rinjtë e të reja viktime të çdo lloj forme të dhunës.
- ✓ *Të rinjtë në rrezik:* Ata që janë në rrezik për të lënë shkollën, nuk kanë akses në burimet arsimore ose përballen me pengesa për punësim dhe zhvillim të karrierës.
- ✓ *Të rinjtë me të ardhura të ulëta:* Të rinj e të reja nga familje ose komunitete me të ardhura të ulëta, të cilët kërkojnë mbështetje për të aksesuar shërbimet thelbësore, si kujdesi shëndetësor, arsimi, strehimi ose mundësitë për karrierë.
- ✓ *Të rinjtë që kërkojnë mbështetje dhe udhëzime:* Çdo i ri që kërkon udhëzime, këshillim, mentorim, ndihmë arsimore, këshilla për karrierë ose burime për zhvillim personal mund t'i drejtohet qendrës për shërbime.
- ✓ *Të rinjtë në tranzicion:* Të rinj e të reja që kalojnë nga kujdestaria, sistemet e drejtësisë për të miturit ose mjedise të tjera institucionale mund të përfitojnë nga shërbimet e përshtatura për të ndihmuar në kalimin e tyre të suksesshëm në moshën madhore të pavarur.

Qendra e Shërbimeve Rinore me një Ndalesë ofron një larmi të madhe shërbimesh ndërsektoriale. Rrjeti i gjerë i partnerëve përfshin këshilltarët për të rinjtë, punonjës socialë, psikologë, profesionistë të sektorit të shëndetit, ekspertë të punësimit, edukimit dhe arsimit profesional, si dhe një sërë ofruesish të tjerë shërbimesh nën një çati. Shërbimet ofrohen përmes kanaleve të ndryshme, të tilla si: ballë për ballë, elektronike, online ose/dhe telefonike.

Këto shërbime synojnë të trajtojnë aspekte të ndryshme të jetës së të rinjve dhe të rejave në Korçë, Pogradec, Devoll dhe Maliq, duke i ofruar atyre burimet dhe mbështetjen e nevojshme për rritjen, zhvillimin dhe suksesin personal. Shërbimet e ofruara mund të ndryshojnë në varësi të problematikave dhe vendndodhjes së të rinjve e të rejave. Qendra e Shërbimeve Rinore me një Ndalesë ofron një sërë shërbimesh të përshtatura për të përmbushur nevojat e ndryshme të të rinjve, si vijon: 1) Edukimi dhe Mësimdhënia; 2) Shërbimet e Punësimit; 3) Shëndeti dhe Mirëqenia, Literatura Digjitalë, Siguria dhe Zhvillimi i Aftësive; 4) Aftësitë e Jetës; 5) Zbavitje dhe Argëtim; 6) Asistencë Juridike.



KUADRI INSTITUCIONAL NË NIVEL KOMBËTAR DHE LOKAL

Vit pas viti kuadri institucional me në fokus çështjet e të rinjve po vjen drejt një përmirësi. Nëse kthehemi pas në kohë dhe i referohemi viteve 2015-2020, bazuar në zbatim të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015-2020, Qeveria Shqiptare në atë kohë duhet të kishte ngritur një kuadër të plotë institucional të mbështetjes së rinisë në Shqipëri. Mosbatimi i planit dhe riformatimi i Ministrive në shtator 2017, solli si rrjedhojë kalimin e çështjeve rinore në administrim të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, duke krijuar një dobësim dhe çorientim rrënjësor të të gjithë sistemit institucional për rininë në Shqipëri.

Mungesa e strukturës institucionale në nivel qendror dhe lokal në atë kohë nuk e bëri të mundur zbatimin e Planit dhe aktiviteteve të parashikuara, si rrjedhojë edhe përbushjen e objektivave të vendosur. Ndonëse Planit parashikonte krijimin e një grupi ndër-ministoror për monitorimin e zbatimit të tij, nuk rezultoi që ky grup të ngrihej apo të funksiononte ndojëherë. Mospasja e një stafi të plotë me të rinj dhe për të rinjtë (vetëm 2 veta), në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Sporteve dhe Rinisë të asaj kohe, kapacitetet tepër të kufizuara të këtij institucioni për të kryer punë për të rinjtë, mungesa e Informacionit transparent të roleve dhe përgjegjësi të tyre, vetëm e shtuan paqartësinë mbi rolet e strukturave dhe funksionet e tyre përkatëse.

Vlen të theksohet se në vitin 2017, riorganizimi i Ministrive dhe funksioneve të tyre solli dhe shkrirjen e të vetmes Drejtorit të Politikave Rinore në Ministrinë e Mirëqënies, Sociale dhe Rinisë, e cila ishte përgjegjëse për zhvillimin e politikave rinore dhe zbatimin e tyre. Ndërsa me shkrirjen e kësaj drejtorie, u krijua për herë të parë edhe portofoli i një Zv. Ministri për Rininë i cili do të ishte përgjegjës kryesor dhe pika kyçe e lidhjes institucionale midis të rinjve në Shqipëri dhe MASR-së. Edhe pse në atë kohë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, së cilës i'u bashkangjiti edhe rinia, pavarësisht portofolit të Zv. Ministrit të Rinisë, nuk pati kurrë asnjë sektor apo drejtori e cila të mund të mbulonte vetëm problematikën e të rinjve dhe të reja.

Katër vite më vonë (2021) për çështjet e të rinjve dhe fëmijëve u krijua Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka si mision mbrojtjen e të drejtave të të rinjve dhe garantimin e pjesëmarrjes së tyre në jetën sociale, nëpërmjet hartimit, zhvillimit dhe monitorimit të politikave rinore, dhe koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen, përkujdesjen, shëndetin, mirërritjen dhe mirëedukimin e fëmijëve. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët synon të fuqizojë përfshirjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse të politikëbërjes, duke mbrojtur të drejtat e të rinjve, duke krijuar kushte të nevojshme për aktivizim e pjesëmarrje.

Si institucion përgjegjës me në fokus rininë dhe fëmijët, Ministri i Shtetit krijon ura bashkëpunimi mes fëmijëve dhe të rinjve të Shqipërisë e atyre të diasporës, me përfaqësuesit e



institucioneve publike e private, si dhe me organizata të shoqërisë civile që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë.

Përsa më sipër, referuar misionit të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, por dhe Ligjit për Rininë, planifikohet që Ministri në fjalë të mund të hartojë, zbatojë dhe monitorojë mbarëvajtjen e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029. Sipas ekspertëve të ndryshëm të fushës së rinisë, bazuar edhe tek organigrama e Ministrit të Shtetit me një staf të reduktuar dhe pa portofol ende nuk është krijuar një Sektor/Drejtori Rinie për përgatitjen e raporteve periodike të zbatimit të SKR 2029, fuqizimit të organizatave rinore, si dhe përgatitjes së propozimeve për politika dhe programe specifike për të rinjtë., etj! Në këtë pikë, ekzistenca e këtij vakumi si në vitin 2017 në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ekspertë të ndryshëm ngrejnë pikëpyetjen nëse Ministri i Shtetit pa portofol dhe pa buxhet do të mund të mbulonte të gjithë punën që do të shërbente për 23% të popullsisë shqiptare që janë të rinjtë?!

Agjencia Kombëtare e Rinisë¹¹

Misioni i Agjencisë Kombëtare të Rinisë pas shkrirjes së Shërbimit Kombëtar për Rininë (SHKR) në vitin 2018, është garantimi i mbrojtjes dhe i promovimit të të drejtave të të rinjve nëpërmjet mbështetjes për edukim joformal, ndërveprimi e aktivizimit të rinisë dhe financimit të veprimtarive, në zbatim të politikave shtetërore në fushën e rinisë. Me implementim të thirrjeve të hapura për organizatat rinore/për të rinjtë dhe ato për njësitë e vetqeverisjes vendore, Agjencia Kombëtare e Rinisë mundëson hapësira dhe mundësi ku të rinjtë mund të mësojnë dhe praktikojnë diturie në një larmishmëri fushash si sporti, TIK, artet, gjuhët e huaja dhe shëndeti mendor e fizik.

Gjithashtu Agjencia Kombëtare e Rinisë është pjesëmarrëse dhe aktive në veprimtari rinore si panairë shkolle, aktivitete kulturore dhe vazhdimisht është në kontakt me të rinjtë të cilët shprehin nevojat dhe dëshirat e tyre. Katër prej funksioneve kryesore të AKR janë:

- *Mbështetja, nxitja dhe promovimi i të drejtave të të rinjve;*
- *Nxitja dhe zhvillimi i dialogut të strukturuar për përfshirjen e sa më shumë palëve, me synim fuqizimin e pozitës së të rinjve në shoqëri;*
- *Sigurimi i kushteve për rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbështetjen e të rinjve nga subjekte vendase ose të huaja;*
- *Krijimi i mekanizmave për zhvillimin dhe nxitjen e politikave rinore, si dhe marrja e vendimeve profesionale cilësore të pavarura, në përzgjedhjen e programeve dhe të projekteve të financuara nga buxheti i shtetit.*

¹¹ Faqja zyrtare e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, lidhja në linkun vijues: <https://rinia.gov.al/misioni/>



Referuar Ligjit për Rininë, njësoj si me Shërbimin Kombëtar të Rinisë, ligji përjashton edhe AKR-në, duke mohuar kompetencat e kësaj strukturel.

Këshilli Kombëtar i Rinisë¹²

Këshilli Kombëtar i Rinisë është organ këshillimor, që funksionon pranë ministrit përgjegjës për rininë. Këshilli Kombëtar i Rinisë ushtron kompetencat vijues: *a) i paraqet ministrit përgjegjës për rininë politikat prioritare, buxhetin dhe veprimtaritë në fushën e rinisë; b) propozon drejtimet dhe programet kryesore për mbështetjen dhe fuqizimin e pjesëmarrjes së të rinjve; c) jep mendim për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë dhe monitoron zbatimin e saj; ç) miraton raportin vjetor mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë dhe situatës së të rinjve.*

Këshilli Kombëtar i Rinisë kryesohet nga ministri përgjegjës për rininë dhe ka në përbërje 14 deri në 16 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Rinisë emërohen me urdhër të ministrit përgjegjës për rininë.

Këshilli Vendor i Rinisë¹³

Bazuar tek Ligji për Rininë, Këshilli Vendor i Rinisë është organ këshillimor, që funksionon pranë kryetarit të bashkisë. Këshilli Vendor i Rinisë ushtron kompetencat si vijim: *a) këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë; b) vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor; c) propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë; ç) bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë.*

Këshilli Vendor i Rinisë kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 4 deri në 6 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e këshillit vendor të rinisë emërohen me urdhër të kryetarit të bashkisë.

Përsa më sipër, vlen të theksohet se edhe Bashkia e Pogradecit prej vitesh ka ngritur Këshillin Vendor të Rinisë që përbëhet prej 8 (tetë) të rinj e të reja si vijim dhe që deri më tani ka funksionuar më së miri: *Mateo Yskollari, Maria Balliu, Flori Hoxha, Klea Gjika, Klea Nasta, Fjona Danglli, Uarda Mançellari, Erjona Mukollari.*

¹² Ligji Nr. 75-2019 "Për Rininë", lidhja në linkun vijues: <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/12/Permbledhie-e-ligjit-dhe-akteve-n%C3%ABnligjore-n%C3%AB-fush%C3%ABn-e-rinis%C3%AB.pdf>

¹³ Ligji Nr. 75-2019 "Për Rininë", lidhja në linkun vijues: <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/12/Permbledhie-e-ligjit-dhe-akteve-n%C3%ABnligjore-n%C3%AB-fush%C3%ABn-e-rinis%C3%AB.pdf>



KËSHILLI RINOR POGRADEC

Këshilli Rinor Pogradec është një organizatë rinore jo formale, që operon në territorin e Bashkisë Pogradec dhe në Njësitë Administrative në varësi. KRP është themeluar nga një projekt 1- vjeçar i USAID me Bashkinë Pogradec, në bashkëpunim me shoqatën 'Unë, Gruaja' dhe Nehemiah Gateway University. Pas mbarimit të projektit në Gusht të 2020-ës, ky institucion autonom ka vijuar aktivizimin dhe projektet me fokus rinor. KRP funksionon në bazë të një statuti dhe organizimi të mirëfilltë ku ka koordinatorët dhe anëtarët përkatës. Rikonstituimi i Këshillit Rinor Pogradec, kryhet çdo vit dhe ka përfaqësues nga të gjitha Shkollat e Mesme të Bashkisë Pogradec. Këshilli Rinor Pogradec harton një kalendar aktivitetsh me mbështetje dhe bashkëpunim të institucioneve dhe aktorëve lokalë.



Sektori i Rinisë në Bashki¹⁰

**TË RINJTË NË
POGRADEC, TË DHËNA
DEMOGRAFIKE**

[Signature]

V. TË RINJTË NË POGRADEC, TË DHËNA DEMOGRAFIKE

Popullata që i referohet kjo strategji është ajo e rinisë së Pogradecit, pra të rinjtë që jetojnë, punojnë dhe studiojnë në territorin e Bashkisë së Pogradecit. Sipas Ligjit Nr. 80/2015 "Për Rininë" kjo përfshin grup-moshën 15-29 vjeç, prandaj si popullatë e përfshirë në këtë strategji është pikërisht kjo grup-moshë.

Sipas Censusit të vitit 2011, bashkia e re e Pogradecit numëron 61.530 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil, 90.976 banorë. Njësia me popullsinë më të madhe pas qytetit të Pogradecit është Njësia Administrative Buçimas me 17.792 banorë, ose 20% e totalit të bashkisë. Njësitë më të vogla të Bashkisë, për nga popullsia, janë Dardhas me 3.794 banorë, Trebinja me 3.355 banorë dhe Velçani me 2.716 banorë. Në tabelën më mëposhtme paraqiten të dhënat e regjistrit të Gjendjes Civile për çdo njësi administrative të bashkisë së Pogradecit të disagreguara sipas grupmoshës dhe gjinisë. Kështu rreth 17% e popullsisë, sipas Gjendjes Civile, është e moshës 0-14 vjeç, rreth 72% e popullsisë është në moshën 15-64 vjeç që nënkupton moshën aktive për punë dhe 10% e popullsisë është në moshën 65 vjeç e lart, që është edhe moshë ekonomisht jo-aktive.

Struktura moshore e popullsisë së Bashkisë së Pogradecit tregon një potencial të madh përse i përket segmentit ekonomisht aktiv të popullsisë (15-64 vjeç). Në kushtet e nxitjes së mundësive për punësim, ky segment ofron një motor të burimeve njerëzore që mund të shtyjë pozitivisht zhvillimin ekonomik të Bashkisë. Por nga ana tjetër Bashkia duhet t'i përgjigjet këtij segmenti me politika që nxisin punësimin.¹⁵

¹⁵ Plani i Mbrojtjes Sociale Bashkia Pogradec 2019 – 2023, lidhja në linkun vijues:
<https://bashkia.pogradec.gov.al/ngarkime/njoftimet/docs/190820201504-plani-i-mbrojtjes-sociale.pdf>



**IDENTIFIKIMI I
PROBLEMEVE,
NEVOJAVE DHE
PRIORITETEVE TË
RINISË**



VI. IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE, NEVOJAVE DHE PRIORITETEVE TË RINISË

Të rinjtë në Pogradec artikulojnë një sërë problematikash që janë të ngjashme me të rinjtë në të gjithë vendin. Pogradeci si një qytet i rëndësishëm në Jug-Lindje të Shqipërisë si dhe një qendër e rëndësishme ekonomike, sociale dhe kulturore paraqet mundësi të panumërta. Pavarësisht kësaj, aksesit i këtyre mundësive nga të gjitha grupimet rinore përbën dhe një ndër pikat kryesore të problematikës që të rinjtë hasin në Pogradec.

Sipas Raportit të 2-të Kombëtar "Rinia në Shqipëri 2019" rreth 94 % e të rinjve janë shprehur se nuk kanë asnjë shpresë për zgjidhjen e problemeve të tyre, si nga institucionet qendrore ashtu edhe ato lokale. Rreth 39% e të rinjve intervistuar, kanë vlerësuar se papunësia është problemi kryesor me të cilin përballen të rinjtë në jetën e tyre. Raporti sjell një realitet shqetësues edhe përsa i përket problemeve të të rinjve jo vetëm me institucionet lokale dhe qendrore, por edhe me besueshmërinë ndaj politikës në Shqipëri. Rreth 89% e të rinjve deklarojnë se bashkitë nuk janë aspak miqësore me të rinjtë dhe thuhet se 57% e të rinjve e vlerësojnë punën e tyre për rininë me zero pikë. Raporti gjithashtu tregon se të rinjtë kanë një nivel tepër të lartë të mosbesimit ndaj politikës në Shqipëri. Rreth 62 % e të rinjve shprehen se nuk besojnë tek asnjë grupim politik, për të trajtuar problemet dhe për të bashkëpunuar me të rinjtë. Rreth 84 % e të rinjve shprehen se partitë politike janë aspak apo shumë pak të hapura për të zgjidhur problemet e të rinjve, duke u shprehur se partitë politike vetëm në 35 % të rasteve konsultohen me të rinjtë vetëm gjatë fushatave elektorale.¹⁶

Raporti evidenton edhe probleme të tjera të rinisë si varfëria rreth 52%, e ndjekur nga të ardhurat e ulta (48%) korrupsioni (43%) dhe mungesa e mbështetjes institucionale për të rinjtë

¹⁶ "Rinia Shqiptare: Problemi apo Investimi i Shkëlqyer?", Lëvizja MJAFT, 2010



(40%). Përsa i përket pushtetit lokal, rreth 89% e të rinjve nuk gjejnë asnjë mjedis miqësor për rininë në Bashkitë e vendit.¹⁷ Një studimi i kryer nga Lëvizja Mjaft në vitin 2010, "Rinia Shqiptare: Problemi apo Investimi i Shkëlqyer?" rekomandon se problemet e rinisë duhet të adresohen dhe koordinohen dhe në nivel lokal dhe zgjidhja e tyre duhet të jetë praktike, me një buxhet të bashkangjitur dhe me një sistem të efektshëm monitorimi. Këto rekomandime gjejnë vënd dhe sot në situatën aktuale.

Në relevancën e këtij Plan Veprimi kjo përkthehet në një stepje dhe në një formë apatie e të rinjve për të marrë pjesë në qeverisje dhe të jenë përgjithësisht të interesuar në politikbërje. Modelet që ofron shoqëria jonë, pra duke renditur median dhe kulturën favorizojnë akasinë, mos-vperim kundër gjykimit më të mirë për të bërë atë që duhet.

Duke marrë në konsideratë 3 shtyllat kryesore të shqetësimit të të rinjve në Pogradec: *arsimin, punësimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në qeverisje arritën të identifikohen problematikat*. Këto problematika janë identifikuar duke përdorur analizën SWOT-Srength, Weakneses, Opportunities, Threats- Pika të Forta, Pika të Dobëta, Mundësi, Riske. Problematikat janë kategorizuar sipas 4 prioriteteve dhe janë përkthyer në objektiva, të cilave i është bashkangjitur dhe një plan masash ose zgjidhje të mundshme. Në këtë kapitull të këtij Plan Veprimi bëhet një zberthim i problematikës dhe përkatësimi i tyre sipas 4 prioriteteve të identifikuara nga të rinjtë. Ndërsa në kapitullin e Prioriteteve bëhet një zberthim i detajuar i mundësive të mundshme të zgjidhjeve.

Identifikimi i të gjithë këtyre jep të qartë situatën reale të rinisë, e cila përmbledhet në 4 prioritetet kryesore:

1. *Arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës,*
2. *Punësimi dhe sipërmarrja Rinore,*
3. *Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor në politikë dhe vendimarrje,*
4. *Art, sport, kulturë (hapësira publike për të rinjtë).*

PRIORITETI 1 - Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës, (infrastruktura dhe mungesat)

Të rinjtë kanë artikuluar problematikat e tyre në lidhje me infrastrukturën e institucioneve arsimore në territorin e Pogradecit, si dhe me mungesat e tyre në kurrikula e më gjerë. Gjithashtu një pjesë e mirë e institucioneve arsimore paraqesin rrezik për të rinjtë, si për shembull shkollat e ndërtuara buzë rrugës së makinave. Në këto shkolla gjatë orëve të fluksit të nxënësve, kryesisht në fillim dhe mbarim të mësimit, kthehet në problem dhe në rrezik hyrja apo dalja në institucion, pasi ka një mungesë hapsire dhe koordinimi.

¹⁷ Raporti Kombëtar "Rinia në Shqipëri 2019", CRCA/ECPAT Shqipëri, Tirana 2019



Duke vazhduar me infrastrukturën e institucioneve arsimore është vënë re një përdorim jo efektiv për hapsirat multifunkionale ashtu dhe mungesë hapsirash të tilla. Këto kanë ndikuar dhe në cilësinë e edukimit duke vërejtur një mungesë të përgjithshme të ndërthurjes së teorisë me praktikën. Mungesa e ambienteve specifike, si laboratorë shkencorë dhe mos funksionimi i rregullt i atyre ekzistues kanë sjellë pengesë në zhvillimin e disa pjesëve të kurrikulës mësimore. Gjithashtu ka dhe mungesë ambientesh për të zhvilluar aktivitete rekreacioni dhe kulturore ose keqpërdorim i hapsirave që mund të shfrytëzohen për këto qëllime.

Të gjitha këto problematika janë grupuar në **PRIORITETI 1**, ku më tej do adresohen zgjidhjet dhe opsionet e mundshme. Adresimi i tyre bëhet dhe me bashkëpunimin e institucioneve të pushtetit qëndror dhe aktorëve të tjerë.

PRIORITETI 2 - Punësimi dhe sipërmarrja rinore

Punësimi është një ndër shqetësimet kryesore të rinisë shqiptare, prandaj do të analizohet duke marrë parasysh të rinjtë në Pogradec. Të rinjtë adresojnë një mungesë adresimi specifik të punësimit rinor në Pogradec, si për shembull mungesa e marrveshjeve të Bashkisë me biznese që punësojnë rininë, me qëllim që të arrihet siguri i interesit më të lartë të të rinjve. Përtej mungesës së skemës për punësim sezonal dhe bashkëpunim me bizneset vërehet dhe pak investim në drejtim të motivimit të sipërmarrjes rinore. Të rinjtë kërkojnë më shumë trajnime, njohuri dhe informime për tu aftësuar për tregun e punës. Bashkia në këtë drejtim mund të luajë një rol koordinues dhe mbikqyrës, për realizimin e këtyre trajnimeve në territorin e saj. Për të vazhduar më tej raportohet një mungesë informacioni të qendëruar për sa i përket punësimit rinor si dhe mos-pasje politikash që motivojnë sipërmarrjen nga ana e të rinjve.

Masat e sugjeruara mbi problematikat në lidhje me punësimin dhe sipërmarrjen rinore janë adresuar duke marrë në konsideratë dhe bashkëpunime të mundshme me aktorë të tjerë, sidomos duke qënë se jo të gjitha zgjidhjet mund të ezaurohen nga Bashkia e Pogradecit.

PRIORITETI 3 - Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor në politikë dhe qeverisje

Pjesëmarrja e të rinjve të Pogradecit në politikbërje dhe qeverisje është një problem jo i vogël. Adresimi në formën e duhur të kësaj problematike mund të sillte përmirësime të dukshme dhe në fushat e tjera të nevojave të të rinjve të Pogradecit, sepse ato vetë do ishin agent ndryshimi në qeverisjen lokale. Vërehet një mungesë informimi nga ana e të rinjve për sa i përket Bashkisë Pogradec dhe institucioneve të saj. Në këtë aspekt shihet si një nevojë imediate për të rritur informimin dhe motivuar të rinjtë që të jenë më aktiv në këtë drejtim. Nga ana tjetër megjithëse pranë Bashkisë Pogradec, funksionon organizata rinore jo formale e Këshillit Rinor



Pogradec dhe Këshilli Vendor Rinor Pogradec, duhet të krijohen më tepër mundës ku të rinjtë të kenë me tepër mundësi për tu përfshirë në aktivitete. Përfshirja dhe konsulenca e të rinjve në politika dhe programe të Bashkisë Pogradec që i afektojnë ato direkte është e vogël. Bashkia e Pogradecit ka një politikë transparente për sa i përket buxhetit, por për rininë ky buxhet është në nivele të pamjaftueshme për të adresuar nevojat e tyre në këtë qytet.

Për sa i përket këtij prioriteti Bashkia Pogradec dhe Këshilli Bashkiak Pogradec konsiderohen si dy aktorë kryesorë duke qënë se ka të bëjë me politikën e saj direkte me të rinjtë.

PRIORETI 4 - ATE, SPORT, LEJDORE (hapësira publike për të rinjtë)

Ky prioritet adreson jetën sociale dhe kohën e të rinjve në Pogradec. Pavarësisht opsioneve që ky qytet interesant ofron për turistët dhe vizitorët e shumtë, Pogradeci nuk është shumë i aksesueshëm për të rinjtë. Aktivitetet argëtuese kërkojnë shpenzime të cilat të rinjtë nuk i disponojnë. Duhet theksuar se Bashkia Pogradec i ka vendosur vetes si prioritet promovimin e të rinjve në art dhe maksimalizimin e aktiviteteve sportive, por përsëri hapësirat publike si dhe mbështetja për promovim me programe dhe aktivitete të ndryshme të talenteve rinore mbeten një problem për të rinjtë e Pogradecit. Pavarësisht nismave të suksesshme të Bashkisë, duhet të ketë më shumë hapësira publike dhe rekreative për të rinjtë. Mbetet e pamjaftueshme sasia e iniciativave për të motivuar dhe promovuar të rinjtë që duan të kthejnë hobit e tyre në talente ose mundësi karriere profesionale.





**MATRICA E PLANIT
TË VEPRIMIT PËR TË
RINJTË 2025-2028**

VII. PLANI I VEPRIMIT PËR TË RINJTË 2025-2028

PRIORITETI 1: ARSIM CILËSOR DHE GJITHËPËRFSHIRËS (INFRASTRUKTURË DHE INVESTIMET)

MASAT E PROPOZUARA

OBJEKTIVA	NDËRHYRJET	INDIKATORËT	AFATET KOHORE	DREJTORITË PËRGJËGJËSE
Ndërhurrje Teori – Praktikë sipas kurrikulave mësimore dhe organizimeve të mundshme përtej tyre.	Krijimi i laboratorëve funksionalë në institucionet arsimore dhe funksionimi i atyre ekzistuese. 1. Identifikimi i numrit të laboratorëve të munguar dhe funksional. 2. Ngritja e një	* Numri i laboratorëve funksionalë në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme; * Buxheti i investuar për rikonstruktimin e laboratorëve ekzistues dhe hapjen e laboratorëve të rinj në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme; * Plani i punës me hapa konkret për realizimin e kësaj mase; * Numri i Takimeve	Janar 2025-Janar 2026	*Drejtoria e Shërbimeve Sociale; *Qendra Arsimore; *Njësia për Integrimin European; *Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse;



plani bashkëpunimi dhe bashkrendimi me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, Ministren e Shtetit për të Rinjtë dhe Fëmijët si institucione qendrore përgjegjëse për këtë hallkë.

3. Identifikimi i bashkëpunorëve të tjerë të mundshëm sidomos në financim dhe implementim.

4. Konsultimi me të rinj për përfshirjen e tyre në këtë proces duke u kujdesur që të jenë pjesë në hallika ku ato mund të kontribuojnë.

5. Ndërtimi i një plani pune me hapa konkret për realizimin e kësaj mase. Në këtë plan pune identifikohet qartësisht përgjegjësia e aktorëve përgjegjës për realizimin e secilës etapë.

konsultuese me të rinjtë.

*Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve;

*Ministren e Shtetit për të Rinjtë dhe Fëmijët.

Ekzistenca, qëndrueshmëria dhe menaxhimi i

1. Krijimi i mjediseve multifunkionale

* Numri i bibliotekave dhe palestrave të reja;
* Numri i bibliotekave

Janar
2025-Janar

*Drejtoria e Shërbimeve



mjediseve shumëfunktionale në institucionet arsimore në Pogradec.	<p>(biblioteka, palestra të reja)</p> <p>2. Rritja e investimeve në palestrat dhe bibliotekat ekzistuese pranë institucioneve arsimore, si kujdes maksimal për mirëmbajtjen e tyre.</p> <p>3. Rivlerësimi për nga funksioni i hapësirave fizike ekzistuese brenda shkollave 9-vjeçare, të mesme dhe institucioneve të tjera arsimore.</p> <p>4. Kontroll i vazhdueshëm për një përdorim më të mirë të të gjitha hapësirave fizike pronësi e çdo shkolle 9-vjeçare dhe të mesme.</p> <p>5. Organizimi sistematikisht i aktiviteteve promovuese për nxënësit e shkollave 9-vjeçare, dhe të mesme.</p>	dhe palestrave të rikonstruara; * Buxheti i investuar për rikonstruktimin e palestrave dhe bibliotekave ekzistuese, si dhe hapjen e bibliotekave/palestrave të reja në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme; * Numri i aktiviteteve promovuese për nxënësit e shkollave 9-vjeçare, të mesme dhe studentët.	2027	<p>Sociale;</p> <p>*Qendra Arsimore;</p> <p>*Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.</p>
Siguria e institucioneve arsimore në qytetin e Pogradecit.	Ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme mbrojtëse për shkollat të cilat hyrjen e kanë buzë rrugës. (polic i shtrirë; kangjella; sinjalistika vertikale	* Inftastuktura dhe sinjalistika rrugore: polic i shtrirë; kangjellat; sinjalistika vertikale dhe horizontale. * Buxheti i investuar për ndërtimin e infrastrukturës së	Janar 2025- Dhjetor 2026	<p>*Drejtoria e Shërbimeve Sociale;</p> <p>*Qendra Arsimore;</p> <p>*Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</p>



dhe horizontale)

nevojshme mbrojtëse për shkollat të cilat hyrjen e kanë buzë rrugës

Mbështetëse;
*Ministria e Arsimit dhe Sportit;
*Drejtoria Vendore e Policisë
Pogradec.

PRIORITETI 2: PUNËSIMI DHE SIPËRMARRJA RINORE

MASAT E PROPOZUARA

OBJEKTIVA	NDËRHRYJE	INDIKATORËT	AFATET KOHORE	DREJTORITË PËRGJËGJËSE
Krijimi i marrëveshjeve të Bashkëpunimit midis Bashkisë Pogradec, bizneseve dhe Institucioneve të ndryshme që punësojnë një numër të konsiderueshëm të rinj.	Lidhja e Marrëveshjeve Bashkëpunimi mes bizneseve, institucioneve të ndryshme dhe Bashkisë Pogradec, ku të: 1. Ofrohen lehtësira fiskale për bizneset/institucionet që punësojnë një numër të konsiderueshëm të rinj e të reja; 2. Ofrohen lehtësira administrative për punësimin e të rinjve; 3. Të motivohet punësimi rinor dhe të vihen në pah avantazhet e tji. 4. Rrjetëzim brenda dhe jashtë vendit për sipërmarrësit e rinj.	* Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit; * Lehtësirat fiskale të ofruara prej Bashkisë; * Numri i të rinjve të punësuar.	Janar 2026- Dhjetor 2028	*Drejtoria e Shërbimeve Sociale; *Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë; *Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar; *Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse; *Bashkia e Pogradecit; *Këshilli Bashkiak i Pogradecit.
Krijimi i punësimit	1. Zhvillimi i skemave të	* Skemat e	Janar 2026-	*Drejtoria e



sezonal për të rinjtë.

punësimi sezonal.
2. Zhvillimi i panairove të punësimi sezonal, për vetë faktin se turizmi është pjesë e strategjisë së Bashkisë Pogradec.

punësimi sezonal;
* Panairot e punësimi.

Dhjetor 2028

Shërbimeve Sociale;
*Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë;
*Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar;
*Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse;
*Drejtoria e Shërbimit të Pyjeve dhe Kullotave;
*Bashkia e Pogradecit;
Këshilli Bashkiak i Pogradecit.
*Drejtoria e Shërbimeve Sociale;
*Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë;
*Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar;
*Njësia për Integrimin Europian;
*Drejtoria e Shërbimit të

Aftësimi efikas dhe proaktiv i të rinjve për tregun e punës.

1. Zhvillimi i trajnimeve të ndryshme për aftësimin e të rinjve në tregun e punës.

* Numri i trajnimeve të zhvilluara.
* Numri i të rinjve të trajnuar.

Janar 2025-
Dhjetor 2026



<p>Politika dhe programe lehtësuese, motivuese dhe mbështetëse për sipërmarrjet rinore dhe sipërmarrësit e rinj.</p>	<p>1. Heqja e taksave për bizneset e reja të drejtuara nga të rinjtë për një periudhë 2-3 vjeçare. 2. Ofrimi i trainimeve dhe kurseve të formimit për të rinjtë mbi sipërmarrjen, taksimin, mundësitë e biznesit, procedurat vendore etj. 3. Ofrimi i Kredive me interes 0% për sipërmarrjet rinore.</p>	<p>* Numri i bizneseve të reja që u janë hequr taksat. * Numri i trajnimeve të zhvlluara; * Numri i të rinjve të trajnuar. * Numri i kredive të dhëna me interes 0.</p>	<p>Janar 2025- Dhjetor 2028</p>	<p>Pyjeve dhe Kullotave; *Bashkia e Pogradecit; *OSHC-të Rinore. *Drejtoria e Shërbimeve Sociale; *Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë; *Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar; *Njësia për Integrimin Europian; *Drejtoria e Shërbimit së Pyjeve dhe Kullotave; *Bashkia e Pogradecit; *OSHC-të Rinore;</p>
<p>Ndërtimi i një pike informuese qëndore për punësimin dhe sipërmarrjen në 9 njësitë administrative në Pogradec.</p>	<p>1. Ngritja e nje strukture koordinuese për krijimin e një Portali Punësimi për të Rinjtë e Pogradecit. 2. Pasurimi i vazhdueshëm i Portalit me lajmërimet për vende të reja pune dhe trainime për të rinjtë. 3. Rakordim i kërkesave për vende pune me</p>	<p>* Struktura koordinuese; * Lajmërimet për punë dhe trajnime;</p>	<p>Janar 2026- Dhjetor 2027</p>	<p>*Drejtoria e Shërbimeve Sociale; *Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë; *Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar;</p>



ofertat e përshtatshme.
4. Rakordim i Portalit të Punësimit në Bashkinë e Pogradecit me Portalin Kombëtar të Punësimit të Rinjve.

*Njësia për Integrimin Europian;
 *Drejtoria e Shërbimit të Pyjeve dhe Kullotave;
 *Bashkia e Pogradecit;
 *OSHC-të Rinore.

PRIORITETI 3: PJESEMARRJA DHE PERFAQESIMI RINOR NE POLITIKA DHE VENDIMMARRJE

MASAT E PROPOZUARA

OBJEKTIVA	NDËRHYRJE	INDIKATORËT	AFATET KOHORE	DR
Mirëfunsonimi dhe efektiviteti i Këshillit Rinor Pogradec pranë Bashkisë Pogradec dhe Këshillit Rinor Vendor në mënyrë që t'u përgjigjet nevojave dhe kërkesave të rinisë së qytetit.	<p>1. Mirëorganizim i Këshillit Rinor Pogradec.</p> <p>2. Informimi i të rinjve mbi çdo nismë dhe hap që ndërmer Këshilli Rinor Pogradec dhe Këshillit Vendor Rinor.</p> <p>3. Këshilli Rinor Pogradec duhet të jetë një strukturë</p>	<p>* Struktura e Këshillit Rinor Vendor dhe Këshillit Rinor Pogradec;</p> <p>* Takimet dhe minutat e takimeve te Bordit dhe Këshillit Rinor Vendor;</p> <p>* Njoftimet e Bordit dhe Këshillit Rinor Vendor për</p>	Janar 2025- Dhjetor 2027	<p>*Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë;</p> <p>*Njësia për Integrimin Europian;</p> <p>*Bashkia e Pogradecit;</p> <p>* Këshilli Bashkiak Pogradec;</p>



<p>Politikat rinore të jenë të hartuara dhe konsultuara në bashkëpunim me të rinjtë si dhe pjesmarrja ose djenija e të rinjve për komisione të posaçme që kanë të bëjnë me to pranë Këshillit Bashkiak.</p>	<p>rinore e pavarur nga Bashkia e Pogradecit dhe Drejtoria e Rinisë së bashkisë.</p> <p>4. Ngritje urash bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë, Këshillit Bashkiak, Këshillit Rinor Pogradec, Këshillit Rinor Vendor dhe të rinjve të qytetit.</p> <p>1. Komisionet e posaçme në Këshillin Bashkiak të Pogradecit duhet të zhvillojnë/të konsultojnë çdo politikë rinore dhe vendim për të rinjtë me çdo organizatë apo të ri të interesuar në qytetin e Pogradecit.</p> <p>2. Informim pro-aktiv i të rinjve për politikat dhe komisionet në lidhje me çështje që janë me interes për to.</p> <p>3. Programe motivuese për pjesmarrjen e të rinjve në politikbërje dhe qeverisje.</p> <p>4. Ngritja e</p>	<p>nismat e planfikuara;</p> <p>* Takimet mes Këshillit Rinor Pogradec, Këshillit Rinor Vendor, Këshillit Bashkiak, Bashkisë Pogradec, Këshillit Kombëtar Rinor si dhe Ministres së Shtetit për fëmijët dhe të Rinjtë.</p> <p>* Takimet konsultuese;</p> <p>* Njoftimet mbi politikat Rinore;</p> <p>* Numri i programeve;</p> <p>* Format e komunikimit të organizatave Rinore dhe Këshillit Bashkiak.</p>	<p>Janar 2025- Dhjetor 2028</p>	<p>*Këshilli Rinor Pogradec</p> <p>*Këshilli Rinor Vendor Pogradec;</p> <p>*OSHC-të Rinore.</p> <p>*Drejtorja e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë;</p> <p>*Njësia për Integrimin European;</p> <p>*Bashkia e Pogradecit;</p> <p>* Këshilli Bashkiak Pogradec;</p> <p>* Këshilli Rinor Pogradec</p> <p>*Këshilli Rinor Vendor Pogradec;</p> <p>*OSHC-të Rinore.</p>
---	---	---	---------------------------------	---



kanaleve të komunikimit mes Këshillit Bashkiak dhe të rinjve, sespe gjithmonë puna e këshillave nuk bëhet e njohur për të rinjtë e qytetit.

Alokimi dhe pasja e një buxheti nga Bashkia Pogradec për të adresuar dhe përmbushur nevojat dhe kërkesat e të rinjve të qytetit.

1. Bashkia e Pogradecit duhet të alokojë një buxhet specifik për të rinjtë bazuar në nevojat reale të tyre.

2. Bashkia e Pogradecit, Drejtoria e Rinisë duhet të fillojnë në kohë konsultimin dhe hartimin me pjesëmarrje të Buxhetit të Rinisë me të gjitha organizatat që punojnë me dhe për të rinjtë, Këshilli Rinor Pogradec si dhe Këshillin Rinor Vendor në qytetin e Pogradecit.

3. Organizatat rinore, Këshilli Rinor Pogradec, Këshilli Rinor Vendor dhe të rinjtë e Pogradecit duhet të përfshihen në

* Takimet konsultuese për buxhetin;
* Buxhet dedikuar të rinjve;
* Numri i organizatave, bordeve, këshillave dhe grupimeve rinore të përfshira në hartimin e buxhetit;
* Nevojat, prioritetet e të rinjve të pasyruara në buxhet.

Janar 2025-
Dhjetor 2026

*Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë Kulturorë dhe Rinisë;
*Njësla për Integrimin Europian;
*Bashkia e Pogradecit;
* Këshilli Bashkiak Pogradec;
* Këshilli Rinor Pogradec;
*Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar;
*Këshilli Rinor Vendor Pogradec;
*OSHC-të Rinore.



Harrelli

procesin e hartimit të Buxhetit të Rinisë prej fazës fillestare, dhe jo pasi ky i fundit është hartuar dhe është gati për miratim në Këshillin Bashkiak të Pogradecit.

Rritje e informimit të të rinjve rreth Bashkisë Pogradec, Këshillit Bashkiak dhe institucioneve të tjera në vartësi.

1. Bashkia e Pogradecit, Këshilli Bashkiak Pogradec, Këshilli Rinor Pogradec dhe Këshilli Rinor Vendor duhet të punojnë me programe dhe fushata ndërgjegjësimi për informimin e të rinjve mbi funksionimin e Bashkisë Pogradec, Këshillit Bashkiak, Komisioneve pranë këtij të fundit.

2. Nxitja e aktiviteteve dhe programeve që të rinjtë të informohen më tepër për mundësitë e ndjekjes së mbledhjeve të komisioneve përkatëse në Këshillin Bashkiak të Pogradecit, të

* Programet dhe fushatat e ndërgjegjësimit;

Janar 2025-
Dhjetor 2027

*Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë;
*Njësia për Integrimin Europian;
*Bashkia e Pogradecit;
* Këshilli Bashkiak Pogradec;
* Këshilli Rinor Pogradec;
*Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar;
*Këshilli Rinor Vendor Pogradec;
*OSHC-të Rinore.



[Handwritten signature]

	<p>cilat nëpërmjet një kërkese mund të ndiqen nga të gjithë qytetarët dhe të rinjtë e Pogradecit.</p>			
<p>Rritja e bashkëpunimit mes organizatave rinore, Këshillit Rinor Pogradec, Këshillit Rinor Vendor, të rinjve, Bashkisë Pogradec dhe Këshillit Bashkiak Pogradec.</p>	<p>Bashkia e Pogradecit, Këshilli Bashkiak duhet të zhvillojnë takime konsultuese, seanca dëgjimore të paktën 1 herë në 6 muaj për:</p> <ol style="list-style-type: none"> të diskutuar dhe konsultuar politika rinore, prioritete, problematika si dhe çështje të ndryshme për të rinjtë që jetojnë, punojnë dhe studiojnë në qytetin e Pogradecit, të analizuar rezultatet e Bashkisë Pogradec, Këshillit Bashkiak të Pogradecit referuar të rinjve. të analizuar shpenzimin e Buxhetit të Rinisë së Bashkisë Pogradec. 	<p>* Numri i takimeve konsultuese, seancave dëgjimore;</p>	<p>Janar 2025- Dhjetor 2028</p>	<p>*Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë; *Njësia për Integrimin Europian; *Bashkia e Pogradecit; * Këshilli Bashkiak Pogradec; * Këshilli Rinor Pogradec; *Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar; *Këshilli Rinor Vendor Pogradec; *OSHC-të Rinore.</p>

PRIORITETI 4: ART, SPORT, KULTURË (HAPËSIRA PUBLIKE PËR TË RINJTË)



Handwritten signature in blue ink.

MASAT E PROPOZUARA

OBJEKTIVA	NDËRHYRJE	INDIKATORËT	AFATET KOHORE	DREJTORITË PËRGJËGJËSE
Përmbushja e prioritetit të Bashkisë Pogradec për promovimin e të rinjve në fushën e artit, sportit (ujor dhe më gjerë), si dhe kulturës.	<p>1. Organizimi i konkurseve të ndryshme kulturore mes shkollave 9-vjeçare dhe të mesme mbi çdo lloj fushë të artit. (<i>art skenik, pamor, muzikë, sport</i>).</p> <p>2. Rritja e aktiviteteve të ndryshme nga Bashkia e Pogradec për promovimin e të rinjve të talentuar, qoftë kjo edhe nëpërmjet rrjeteve të ndryshme sociale.</p> <p>3. Organizimi i kampionateve të ndryshme (të sportit uJOR dhe më gjerë) ndërmjet shkollave dhe universiteteve në fusha të ndryshme sportive.</p> <p>4. Organizimi i aktiviteteve rinore (sportive) kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>5. Ndërmarrja e nismës "Netët e vona buzë Liqenit", me qëllim promovimin e turizmit dhe</p>	<p>* Numri i konkurseve kulturore, festivaleve kombëtare dhe ndërkombëtare;</p> <p>* Numri i aktiviteteve promovuese;</p> <p>* Numri i kampionateve dhe aktiviteteve të ndryshme sportive kombëtare dhe ndërkombëtare të organizuara;</p> <p>* Numri i nismave të ndërmarra si "Netët e vona buzë Liqenit."</p> <p>* Numri i të artistëve të rinj të punësuar;</p> <p>* Numri i praktikave profesionale;</p>	Janar 2025- Dhjetor 2028	<p>*Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë;</p> <p>*Njësia për Integrimin Europian;</p> <p>*Ndërmarrja e Parqeve dhe Rekreacionit;</p> <p>*Bashkia e Pogradecit;</p> <p>*Këshilli Bashkiak Pogradec;</p> <p>*Këshilli Rinor Pogradec;</p> <p>*Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar;</p> <p>*Këshilli Rinor Vendor Pogradec;</p> <p>*OSHC-të Rinore.</p>



Handwritten signature in blue ink.

Krijimi, mirëfunksionimi dhe mirëmenaxhimi i hapsirave dhe mundësive që të rinjtë të ushtrojnë art, kulturë, sporte dhe forma të tjera rekreative.	<p>argëtimin e të rinjve apo trajtimin e problemeve sociale.</p> <p>6. Organizimi i festivaleve të ndryshme rinore kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>7. Punësim dhe ofrim i praktikave profesionale për të rinjtë e talentuar, artistët e rinj.</p> <p>1. Ndërtimi i Laboratoreve të Artit për çdo shkollë 9-vjeçare dhe të mesme.</p> <p>2. Hapja e Qendrave Multifunkionale për të 9 Njësitë Administrative të Pogradecit.</p> <p>3. Rikonstruksioni teatrit, bibliotekës dhe kinemasë si qendra multifunkionale me qëllim që të rinjtë të ushtrojnë talentet e tyre.</p> <p>4. Krijimi i Klubeve Rinore: Klubi i Teatrit; Klubi Social; Klubi i Multimedias; Klubi i Sporteve; Klubi i Mjedisit; Klubi i Bamirësisë, etj.</p>	<p>* Numri i laboratorëve të ndërtuar;</p> <p>* Numri i Qendrave Multifunkionale të hapura;</p> <p>* Numri i teatrove, bibliotekave dhe qendrave multifunkionale të rikonstruktara;</p> <p>* Klubet Rinore: Klubi i Teatrit; Klubi Social; Klubi i Multimedias; Klubi i Sporteve; Klubi i Mjedisit; Klubi i Bamirësisë.</p>	Janar 2025- Dhjetor 2028	<p>*Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë;</p> <p>*Bashkia e Pogradecit;</p> <p>* Këshilli Bashkiak Pogradec;</p> <p>* Këshilli Rinor Pogradec;</p> <p>* Ndërmarrja e Parqeve dhe Rekreacionit;</p> <p>* Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike;</p> <p>*Këshilli Rinor Vendor Pogradec;</p> <p>*OSHC-të Rinore.</p>
Ndërmarrja e fushatave dhe	1. Ndërmarrja e fushatave të	* Numri i fushatave	Janar 2025- Dhjetor 2028	*Drejtoria e Turizmit



nismave të ndryshme ndërgjegjësuese dhe sensibilizuese për mbrojtjen dhe përkujdesjen ndaj mjedisit, si dhe promovimin e fshatrave turistike.	ndryshme sensibilizimi (në shkollë dhe jo vetëm) për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe promovimin e fshatrave turistike të braktisura. 2. Ndërmarrja e nismave të ndryshme për nxitjen e aktivizimit vullnetar të të rinjve në punë publike, si psh: 1 ditë vullnetarizëm në muajt	ndërgjegjësuese për mbrojtjen dhe përkujdesjen ndaj mjedisit si dhe promovimit të fshatrave turistike; * Numri i nismave të ndryshme për nxitjen e aktivizimit vullnetar të të rinjve.		Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë; * Bashkia e Pogradecit; * Këshilli Bashkiak Pogradec; * Këshilli Rinor Pogradec; * Ndërmarrja e Parqeve dhe Rekreacionit; * Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike; * Këshilli Rinor Vendor Pogradec; * OSHC-të Rinore.
Krijimi i një kalendari që reflekton tërësinë e aktiviteteve, eventeve dhe programeve që ofrohen për rininë në qytetin e Pogradecit.	1. Krijimi i një Aplikacioni Kalendarik për aktivitetet rinore kulturoro-artistiko-sociale si më poshtë: Art; Sport; Mjedis; Trashëgimi kulturore, etj. 2. Aplikacioni Kalendarik të jetë online ku të rinjtë dhe qytetarët e Pogradecit, por jo vetëm të mund të rezervojnë online pjesëmarrjen e tyre.	* Aplikacioni Kalendarik për aktivitetet.	Janar 2025- Dhjetor 2028	* Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë; * Njësia për Integrimin European; * Bashkia e Pogradecit; * Këshilli Bashkiak Pogradec; * Këshilli Rinor Pogradec; * Këshilli Rinor Vendor Pogradec; * OSHC-të Rinore.



[Handwritten signature]

**BUXHETIMI DHE
MONITORIMI I
ZBATIMIT TË PLANIT TË
VEPRIMIT**



VIII. BUXHETIMI I PLANIT TË VEPRIMIT

Çdo fund-vit, Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë në Bashki do të paraqesë planin e punes për vitin pas-ardhës për zbatimin e Planit Lokal të Veprimit, së bashku me buxhetin respektiv.

Ky buxhet i planifikuar bazuar për secilin objektiv të poshtë-listuar, do të marrë miratimin nga Këshilli Bashkiak dhe do të zbatohet në vitin pasardhës. Buxheti vjetor dhe plani vjetor në zbatim të këtij Plani Veprimi, përgatiten në konsultim me Komisionin Qytetar për Rininë të Këshillimit Bashkiak Pogradec, Këshillit Vendor Rinor dhe organizatat e shoqërisë civile të rinjve në Pogradec.

1. *Arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës,*
2. *Punësimi dhe sipërmarrja Rinore,*
3. *Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor në politikë dhe vendimarrje,*
4. *Art, sport, kulturë (hapësira publike për të rinjtë).*

IX. MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT

Monitorimi është një aktivitet i vazhdueshëm i cili përfshin mbledhjen e të dhënave dhe informacionin e kërkuar për matjen e indikatorëve të përcaktuar. Gjithashtu, ai është një instrument që do të përdoret për të vlerësuar nëse aktivitetet e planifikuara po zbatohen në praktikë sipas specifikimeve përkatëse të PLVR-së si dhe në të njëjtën kohë do të mbledhë informacionin e nevojshëm mbi arritjet dhe problematikat që mund të dalin gjatë zbatimit të këtij plani.

Bashkia e Pogradecit dhe Këshilli Bashkiak do të kenë rolin kryesor në monitorimin, koordinimin dhe menaxhimin e Planit Lokal të Veprimit për të Rinjtë. Për të patur një format të plotë raportimi i cili do të bëjë të mundur paraqitjen cilësore të arritjeve të PLVR-së, do të hartohet formati përkatës i raportimit. Bashkia e Pogradecit do të jetë përgjegjëse për hartimin e raportit i cili do të jetë një herë në vit. Ky raport do të prezantohet, diskutohet dhe analizohet me aktorë dhe grupe të ndryshme të interesit në një seance të posaçme raportuese të organizuar nga Bashkia e Pogradecit në fund të çdo viti. Në të njëjtën kohë, raportet vjetore do të jenë të hapura për shoqërinë civile dhe publikun të cilët do të japin komentet dhe opinionet e tyre në lidhje me zbatimin e aktiviteteve të PLVR-së.

Gjithashtu, 1 herë në 6 muaj, Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë dhe Drejtoria e Buxhetit pranë Bashkisë Pogradec duhet të informojnë të rinjtë, organizatat rinore dhe grupet e ndryshme të interesit mbi rezultatet e arritura në raport me aktivitetet dhe buxhetin e përdorur sipas Matricës së PLVR-së. *Shoqëria civile nxitet që të përgatisë raporte të ndryshme monitorimi për zbatimin e Planit Lokal të Veprimit.*



BIBLIOGRAFIA

- **Ligji Nr. 75-2019 "Për Rininë"**, lidhja në linkun vijues:
<https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/12/Permbledhje-e-ligjit-dhe-akteve-n%C3%ABnligjore-n%C3%AB-fush%C3%ABn-e-rinis%C3%AB.pdf>
- **Ligji Nr. 69/2012 "Për Arsimin Parauniversitar"**, lidhja në linkun vijues:
https://www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/Ligji_Parauniversitar.pdf
- **Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Arsimin e Lartë"**, lidhja në linkun vijues:
https://unitir.edu.al/eng/wp-content/uploads/2019/08/Ligj_80-2015_22.07.2015.pdf
- **Ligji Nr. 15/2019 "Për Nxitjen e Punësimit"**, lidhja në linkun vijues:
https://akpa.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/ligj-nr-15-dt-13.3.2019_nxitja-e-punesimit.pdf
- **Ligji Nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor"**, lidhja në linkun vijues:
https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Ligji_Nr.44_2012_per_shendetin_mendor.pdf
- **Faqja zyrtare e Agjencisë Kombëtare të Rinisë**, lidhja në linkun vijues:
<https://rinia.gov.al/misioni/>
- **Faqja zyrtare e Bashkisë Pogradec**, lidhja në linkun vijues:
<https://bashkiapogradec.gov.al/faqe/organigrama-e-bashkise-se-pogradecit-9/>
- **Organigrama e Bashkisë Pogradec**, lidhja në linkun vijues:
<https://bashkiapogradec.gov.al/faqe/organigrama-e-bashkise-se-pogradecit-9/>
- **Plani i Mbrojtjes Sociale**, Bashkia Pogradec 2019 – 2023, lidhja në linkun vijues:
<https://bashkiapogradec.gov.al/ngarkime/njoftimet/docs/190820201504-plani-i-mbrojtjes-sociale.pdf>
- **Raporti Kombëtar "Rinia në Shqipëri 2019"**, CRCA/ECPAT Shqipëri, Tirana 2019
- **Studimi "Rinia Shqiptare: Problemi apo Investimi i Shkëlqyer?"**, Lëvizja MJAFT, 2010
- **"Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe Plani i Veprimit 2022-2029"**, lidhja në linkun vijues:
<https://riniafemijet.gov.al/strategjia-kombetare-e-rinise-2022-2029-tashme-miraturar/>
- **VENDIM Nr. 541, datë 19.9.2018 PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË DREJTËSISË PËR TË MITUR DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT 2018–2021**, lidhja në linkun vijues:
<https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/Strategjia-e-Drejtësisë-per-te-Mitur-PV-2018-2021-miraturar-VKM-nr.541-dt.19.9.2018.pdf>

